Abaz T. Hoxha



Në gjurmë të Filmave për Shqipërinë

Kujtime-mbresa-shënime udhëtimi

Shtëpia Botuese Typshkroja ILAR

ABAZ T. HOXHA

Në gjurmë të filmave për Shqipërinë

TIRANË, 2007

Kopertina: Abaz T. Hoxha
Përpunimi në kompjuter: Abaz T. Hoxha

Copyright © by A. T. Hoxha

ISBN 999.....

Të gjitha të drejtat të rezervuara
Ndalohet botimi, fotokopjimi ose shumfishimi me çdo llojë forme ose mjeti pa lejen e autorit.

Botuar nga :

Shtëpia Botuese Typshkronja ILAR®

Përmbajtja

1. Hapat e para
/ Në dallgët e trazuara të jetës/ *5*

2. Drejt fondit filmik arkivor 11

3. Fillimet e punës kërkimore 15

4. Drejt arkivave kinematografike evropiane 30

5. Kërkimet në Arkivat Kinematografike të Vienës
- Mbresa dhe shënime udhëtimi nga disa arkiva kinematografike Austriake. *35*
- Osterreichische filmmusseum *39*
- Wien! *44*
- Osterreichische filmarchive *46*
- Prater 50

6. Midis kolegëve .....
/Shënime dhe mbresa udhëtimi nga R. F. Gjermane/ *67*
- Frankfurt mbi Main *70*
- Bundesarchiv Koblenz *74*
- Drejt Berlinit Perëndimor *80*
- Potsdam *81*
- Berlin *81*

7. Një princeshë e Ilirisë në qëndër të një filmi danez 98

8. Odisea e një libri 113

NË GJURMË TË HISTORISË SË KINEMASË

"Njeriu që nuk ka lënë gjurmë në jetë është e kotë që ka jetuar"

Hapat e para
/Në dallgët e trazuara të jetës/

Për ngjarje të pakëndëshme e pata mjaft të vështirë të punoja në sektorë që kishin të bënin me drejtimin.Në drejtim ndeshesha shpesh me personalitete të cilët donin gjithnjë të imponoin mendimin e tyre nëpërmjet funksioneve që kishin në Parti dhe në Shtet. Këto mendime të imponuara unë nuk i honepsja dot dhe gjithnjë ndeshesha duke mbrojtur mendimin tim. Flitesh gjithmonë për fusha dhe çështje ku unë isha kompetent se kishin të bënin me profesionin ose përvojën time shumëvjeçare. Unë isha kuadri i parë me arsim të lartë në kinematografinë shqiptare dhe erdha i shkolluar por kinematografia mua më mësoi më shumë se librat e shkollës. Duke u ndeshur çdo ditë me probleme nga më të ndryshmet-që nga ato teknike si drejtues teknik i kinostudios dhe i rrjetit kinemtografik të vendit / n'atë kohë gjithë kinematë e Shqipërisë vareshin nga kinostudio/ e deri tek probleme krijuese që nga skenari, regjia e diskutimet e filmave, montazhi, zëri, përkthimet e subtitrimi i filmave, reklama e propaganda etj. Unë vetë u rrita gradualisht por edhe u ndesha me konflikte të ndryshme brënda kinostudios e deri në instancat më të larta shtetërore e partiake. Kinostudio mbeti një kohë pa drejtor dhe një kohë tjetër drejtori ishte i sëmurë,pra si i vetmi kuadër me arsëim të lartë,dashur pa dashur u detyrova të merresha me të gjitha problemet e

kinematografisë.Në vitin 1959 u emërua si drejtorLlazar Lipivani.Ai ishte një njeri i mrekullueshëm dhe i aftë. Me të kishe qejf të bashkëpunoje. Te Llazari gjeta njeriun ku mund të mbështetesha pa rezerva.

Por rrethanat e prunë që ai të largohej dhe të zëvëndësohej me një drejtor tjetër(edhe ky me arsim të mesëm) që ende pa shkelur në kinostudio i ishte mbushur mëndja se i njifte nëpër gishta të gjitha problemet dhe nuk donte të ja dinte për askënd.Ndoshta këtë besim të tepëruar në vetvete ia kishte krijuar kariera e gjatë në poste drejtonjëse deri në Komitetin Qëndror të Partisë dhe lidhjet e tij të ngushta me krerët kryesore të Partisë-shtet. Edhe fushat artistike edhe ato teknike ishin fushat e tij ku vetëm mund të jepte mënd, prandaj regjisorët, skenaristët, inxhinerët, piktorët, kompozitorët etj rrinin me orë të tëra prapa derës së tij për t'i pritur.Qëndrimet e tij arrogante e prepotente, jo vetëm karshi meje, krijimi i një rrjeti të brendëshëm spiunazhi, vëzhgimi e survejimi se ç'farë thuhesh për të, korrupsioni nëpërmjet të sistemit të pagave ose me shpërblime për njerës që nuk i meritonin por ngaqë i shërbenin karrikes së tij, vënia e kuadrove kundër njëri tjetrit etj m'a vështirësoi shumë punën dhe më kaloi në strese.

Por kishte edhe persona të tjerë që nuk më linin rehat me intriga e prapaskena nga më monstruozet, që thurnin të pa-qëna kafeneve e intrigonin duke përdorur emra të personaliteteve të larta shtetërore e partiake me të cilët i lidhnin si profesioni ashtu edhe lidhje familjare e miqësore. E hiqnin vehten si mbrojtës të flaktë të regjimit dhe të parimeve, të Partisë dhe Socializmit dhe donin të zbulonin "armikun e klasës", por që kur erdhi një rast i vetëm e braktisën padronin dhe u maskuan bukur. Këto nuk ishin thjeshtë shfaqje servilizmi me tendencën që të përkëdheleshin e të bënin karierë, por arsyeja tjetër ishte se u prekeshin interesat immediate, u ulesh vlera për shumë zbrazësi mendimesh e mungesë arsimi e kulture, u hiqeshin privilegjet që kishin në sajë të serviliznit

të tyre. Më shkurt ata nuk donin të dëgjohej zë tjetër përveç zërit të tyre të dobët që e kishte burimin në militantizmin e tyre të shtirë. Këtë nuk e bënin vetëm me mua, por me të gjithë ata që nuk i mposhtnin dot në aftësitë intelektuale e mendore. Donin të ushtronin një pushtet absolut mbi të gjithë në sajë të ndonjë merite të zmadhuar nga Lufta Nacional-çlirimtare.Askush nuk duhej t'u kundërshtonte se e gjente belaja dhe donin t'u imponoheshin duke folur edhe në emër të miqve të tyre që ishin në pushtet.

Unë gjithmonë e kam patur zakon që mendimet e mija i thoshja hapur, të ëmbla ose të hidhura. Kjo "kryeneçësi" imja duhej të mposhtej me çdo kusht dhe menduan disa prej tyre se me mua do t'a kishin të lehtë të më luftonin-sigurisht në mbrapaskenë, mbrapa krahëve, të krijonin opinione. Unë e kisha një "cen", biografinë,simbas koncepteve të tyre. Unë vetë kisha marrë pushkën qysh 13 vjeç dhe kisha dalë malit për çlirimin e vendit, por babai im kish qënë një nga krerët e nacionalizmit në Vlorë dhe ndodhesh në burgun e Burrelit. Ky ishte një argument më se i mjaftueshëm për ta për të më hequr qafe.. Prandaj pata shumë peripeci dhe më krijuan një gjendje të rëndë shpirtërore.

Përveç kësaj, duke qënë kryeinxhiner shpesh herë zëvëndësoja drejtorin.Kjo bëri të ndeshem me shumë njerëz, për kusuret e mija, por më shumë të të tjerëvet. Qëllimin kryesor të drejtorit për të më kundërvënë me autorët e skenarëve dhe kuadrot e tjera krijonjëse(ndonse vendimet ishin të tijat) e kuptova tepër vonë.

Këto e shumë ngjarje të tjera më lodhën e dërmuan shpirtërisht. Punoja me shumë pasion për kryerjen e detyrave, por isha gjithmonë si nën kontroll, me një frikë që të mos u jepja rast intrigantëve të më kapnin në ndonjë gabim qoftë edhe të vogël por që do e ngrinin në sistem..

Të gjitha këto si dhe një pasion i heshtur që më vlonte përbrënda për t'u marrë me punë kërkimore më bënë që t'i futem

fushës të lodhëshme të studimeve ku mendoja se do gjeja një qetësi shpirtërore.

Një arsye tjetër që më nxiti të merrem me studime ishte edhe fakti se unë kurrë nuk i kam honepsur njerzit që duan ta quajnë vehten "qëndra e botës" që lindjen dhe ekzistencën e çdo gjëje e lidhin me qënien e tyre.. Në veçanti nuk kam honepsur dot tendencën e shteteve të mëdha për të përvehtësuar çdo gjë të shteteve të vegjël, për të marrë rolin e ideatorëve dhe tutorëve.

Dëgjoja shpesh që kinematografia shqiptare lindi më 1952, pra kur u ngrit ndërtesa e kinostudios dhe kur aty erdhën 5-6 kursantë që bënë një përgatitje një ose dy vjeçare në Studiot e Filmave Dokumentarë në Moskë. Kjo tezë mbrohesh edhe nga rusët që trumbetonin se ata ishin themeluesit e kësaj kinematografie.Këtë e dëgjova edhe në një emision të Radio Moskës me rastin e 28-29 nëntorit 1961. Kjo më revoltoi.. Edhe jugosllavët thoshnin se ata ishin krijuesit dhe një ide të tillë e kishin edhe bullgarët se atje u montuan dy-tre filma dokumentarë /në Sofie/.

Këto më nxitën që t'u futem arkivave dhe në veçanti të merrem gjërësisht me shtypin e kohës.Sigurisht që e fillova nga viti 1945, se ne atë kishim vit referimi.Kështu thoshte propaganda- " çdo gjë në Shqipëri lindi mbas çlirimit kur erdhi Partia".Edhe unë me këtë psikologji isha rritur dhe edukuar.

Në gazetën "Bashkimi" të vitit 1947 gjeta një shkrim që bënte fjalë për Ndërmarrjen Kinematografike Shqiptare. Por kur ishte krijuar ajo ?, Me ç'farë Dekreti ?

Iu drejtova për ndihmë Arianës, një mbesës sime që punonte si stenografe në Kuvëndin Popullor. I kërkova të më gjente koleksionin e "Gazetave Zyrtare" të viteve 1945-1947. Gjeta dokumentin që më duhesh fillimisht për të hedhur poshtë tezën që qarkullonte për "krijuesit" shqiptarë, rusë, jugosllavë etj. Ishte Dekreti Nr.308 i 7 prillit 1947 i cili bënte fjalë që Ndërmarrja

Shtetërore Kinematografike Shqiptare shpallesh si ndërmarrje me rëndësi të përgjithëshme shtetërore. Ky ishte një dokument i rëndësishëm që hidhte poshtë tezën e rusëve dhe të ndonjërit brënda kinostudios që thoshnin se ajo lindi më 1952. Përveç të tjerave rusët më 1947 ende nuk kishin hyrë në Shqipëri dhe tek ne atëhere dominonin jugosllavët.

Ishte viti 1964. Me rastin e festave të nëntorit në kinostudio u bë një sesion shkencor mbi arritjet e kinematografisë. Aty përsëri u hodh teza e lindjes së kinematografisë më 10 korrik 1952. Indirekt thuhesh se kinematografinë shqiptare e krijoi ai që kishte filluar punë në atë kohë. Në sesionin shkencor merrte pjesë edhe Sekretari i Komitetit të Partisë të Rajonit Nr.1 që mbulonte administratën e lartë shtetërore si dhe Institucionet e Kulturës dhe artit. Mbajta edhe unë një kumtesë ku trajtoja tre probleme, por ku dominonte mendimi se Kinematografia shqiptare nuk lindi më 1952 dhe se atë nuk e krijuan as rusët dhe as jugosllavët. Sigurisht që pati reagime nga ata që donin të vërtetonin se "nëna dhe babai" i Kinematografisë shqiptare ishin vetë. Kjo tezë u pëlqeu edhe pushtetarëvet sepse ishte në harkun kohor që ata ishin në fuqi dhe për kontradiktat e acaruara të Shqipërisë me rusët dhe jugosllavët në atë kohë. Këtë tezë e mbrojta më vonë edhe me matërialet paraprake dhe në Konferencën e shtypit që mbajta në Festivalin e Parë të Filmit Ballkanik që u mbajt në Varna të Bullgarisë (gusht,1965) ku kisha shkuar së bashku me regjisorët Kristaq Dhamo dhe Viktor Gjika. /kumtesa ime ndodhet pranë Arkivit Shtetëror të Filmit në Tiranë/.

Hë për hë, kjo datë, domethënë prilli i vitit 1947 mbeti si pikë referimi për lindjen e kinematografisë shqiptare. Prandaj edhe Festivalet e Filmit Shqiptar që filluan të zhvilloheshin nga viti 1976 /Festivali i Parë/, edhe festat e ndryshme të kinematografisë shqiptare bëheshin në muajin prill duke iu referuar prillit të vitit 1947.

Por nuk ndalova me kaq. U futa në studime më të thella. Mora gazetën "Bashkimi"- të vetmen që botohesh në Shqipëri deri në vitin 1948- dhe e shfletova faqe për faqe, ditë për ditë e vit për vit, deri në vitin 1950.

Gjeta matëriale mjaft interesante. Gjeta atmosferën e kohës, gjeta pasionin dhe etjen e madhe të popullit për kulturë e dijë, gjeta solidaritetin popullor në ditë të vështira. Midis tyre gjeta edhe një lëvizje popullore, me në krye arsimtarët- për të ngritur kinema edhe në zonat më të mbrapambetura. Këto kinema ndërtoheshin me kontribut vullnetar, me ndihmat e popullit. Dikush jepte qereste, dikush grumbullonte gurë e tulla, dikush vinte në dispozicion kafshët për ngarkesë dhe dikush tjetër ndërtonte pa pagesë ose jepte pak të holla nga qesja e tyre e varfër.

Këto ishin burim i madh frymëzimi që më entusiazmuan.Ato dëshmonin kryesisht një etje të madhe për dije e kulturë. Më vonë, kur u futa më thellë në shtyp do të zbuloja se kjo etje i kishte rrënjët akoma më të thella, që në fillim të shekullit kur ende nuk ekzistonte shteti shqiptar.

Aty gjeta një dokument te rëndësishëm që tregonte për dekretin e 22 dhjetorit 1945 të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për vendosjen e Monopolit Shtetëror mbi "*Zgjedhjen, Importimin dhe Shfaqjen e filmave në Shqipëri*" dhe dy ditë më vonë, me 24 dhjetor, edhe krijimin e "*Agjensise Shqiptare të Filmit*" që do të administronte këtë monopol, do të administronte kinemanë e pushtuesve që ishte sekuestruar, do me merresh me organizimin, zgjerimin dhe shpërndarjen e filmat në të gjitha kinematë private shqiptare dhe do të çelte edhe një laborator për xhirimin e filmave në Shqipëri. Pra kjo shënonte themelimin e një kinematografie kombëtare Shqiptare me të gjitha funksionet e saj.Kështu që ideja ime fillestare për lindjen e Kinematografisë Shqiptare si një institucion i organizuar u spostua nga prilli i vitit 1947 në dhjetorin e vitit 1945.

Drejt Fondit Filmik Arkivor

Kjo dëshirë, ky pasion i madh, kjo etje e popullit për tu kulturuar më dha forca për t'u futur më thellë në kërkime për të gjetur burimet e saj. Vendosa që për disa kohë të shkëputesha nga gjurmimet në periudhën e mbas çlirimit, për të kërkuar më thellë në vite.

Thuhej se çdo gjë në Shqipëri lindi, u formua dhe u zhvillua pas çlirimit. Por lindëte pyetja: Po më parë në kohën e okupacionit dhe më thellë akoma ç'farë gjurmë të filmit kishte ? Italia ishte një shtet shumë më i përparuar se ne në shumë aspekte dhe në veçanti në fushën e kinemasë. Dihesh se italianët kishin hyrë thellë në Shqipëri sidomos mbas vitit 1926 kur u lidhën disa pakte midis tyre dhe shtetit shqiptar. A ishte e mundur që italianët të mos kishin filmuar në Shqipëri, në mos më parë por të paktën mbas pushtimit qoftë edhe për të propaganduar synimet e tyre ndaj Shqipërisë? Kisha parë një kronikë mbi pushtimin e Shqipërisë. Dhe fillimisht vendosa të shifja filmat që ndodheshin në Filmotekën e Kinostudios që kishin mbetur nga koha e pushtimit.Mundësitë i kisha.Deri në vitin 1965 Filmoteka varej administrativisht nga unë. Aty ndodheshin reth 350 kronika italiane dhe gjermane me ngjarje të xhiruara në vitet 20-të e 30-të si dhe nga Lufta e Dytë Botërore. Ndër to kishte shumë pak që ishin xhiruar direkt në Shqipëri, ndonse ishin pjesë kronikash me mungesa planesh dhe në film të djegëshëm nitrocelozë. Ishin nga filmat që kishin qarkulluar nëpër kinematë tona dhe ishin bërë copë duke u shfaqur me dhjetra herë në aparatet e vjetra të kinemave tona. Megjithatë ato jepnin një ide mbi ngjarjet

e kohës, në veçanti ngjarje politike, nga jeta dhe vizitat e Mbretit Zog, shpallja e tij si Mbret, ceremoni të shpalljes së Mbretnisë, vizitat e ministrit të jashtëm italian Kontit G.Ciano dhe të ministrave të tjerë italianë në Shqipëri, martesa e Zogut me Konteshën hungareze Geraldina Apony,kronika nga pushtimi italian,vizitat e gjeneralëve dhe personaliteteve fashiste,vizita e Vitorio Emanuelit,një ceremoni varrimi gjatë pushtimit gjerman të një personaliteti politik të kohës(Fuat Dibrës) etj.

Për vlerat e mëdha të fondit filmik kisha një dobësi. Ato ishin historia e gjallë e kombit. Kjo ishte edhe arsyeja që kur na u bë për së dyti ose për së treti herë kërkesa nga Federata Ndërkombëtare e Arkivave të Filmave (FIAF) për tu bërë antarë të saj unë, megjithëse ishte tepër e vështirë dhe duhej të mendoheshe mirë për t'u propozuar organeve të larta shtetërore dhe partiake aderimin në një Organizatë Ndërkombëtare, e bisedova paraprakisht këtë çështje me Pipi Mitrojorgjin (ish zv/ministër i Kulturës) me të cilin kisha marrdhënie të mira. Ai mbulonte edhe kinematografinë dhe kishte një vizion më të mirë për problemet e kulturës. Ai vinte nga radhët e rinisë së luftës dhe me lidhje konfidenciale me Ramiz Alinë, i cili kishte qënë Ministër i Arsimit dhe Kulturës dhe në atë kohë ishte anëtar i byrosë Politike dhe Sekretar i Komitetit Qëndror të Partisë. Ramizi përgjithësisht kishte ruajtur disa tipare të shoqërisë së luftës dhe komunikonte më natyrshëm me shokët e tij të dikurshëm dhe me institucionet kulturore artistike që kishin lidhje me të. Shfrytëzova edhe një bisedë të lirë me Manush Myftiun (Zv/kryeministër dhe minister i Arsim-Kulturës) gjatë një pauze të mbledhjes së kolegjiumit të Ministrisë së Arsimit ku më kishte thirrur në funksionin e kryeinxhinerit të kinostudios dhe në mungesë të drejtorit që në atë kohë ishte i sëmurë dhe ishte shtruar në spitalë. Terreni u parapërgatit. Pipi që e miratoi në parim propozimin tim dhe të Llazar Lipivanit që atëhere ishte drejtor, bisedoi me Reiz

Malilen që në atë kohë ishte zv/ministër i jashtëm dhe njeri me vizion e tolerancë. Unë mendoja dhe mendoj akoma se ishte një njeri kurajoz me personalitet dhe e ngrinte zërin për marrdhëniet e Shqipërisë me jashtë, sigurisht në suazën e mundësive të vetë sistemit. Ndoshta nga fakti se ai vinte nga kuadrot e luftës dhe kishte njohje të afërta me Hysni Kapon e Manush Myftiun si ish komisar i një batalioni partizan të brigadës së pestë dhe ndoshta edhe nga fakti se ish i kunati i R.Alisë. Pra fjala e Reizit dëgjohesh. Të gjitha këto të marra së bashku si edhe një bisedë paraprake me Tefik Çaushin që ishte zv/drejtor i kulturës në komitetin Qëndror të Partisë, njeri me kulturë që e vlerësonte shumë kinematografinë dhe nuk dallohesh për ekstremizma të majta e dëgjohesh nga Nexhmie Hoxha, bënë që në vitin 1963 të miratohesh aderimi i filmotekës sonë si Antare e Federatës Ndërkombëtare e arkivave të Filmit FIAF në Kongresin e Beogradit ku ne u përfaqësuam nga një punonjës i ambasadës sonë atje.

Kjo ndodhi në pranverën e vitit 1963. Pranimin në këtë organizatë unë e shifja në një plan të gjerë, për të krijuar lidhje me arkivat e shteteve që kishin përvojë, për të kërkuar filma që kishin lidhje me Shqipërinë të xhiruara nga kineastë të shteteve evropiane nga fillimi i shekullit dhe për të marrë përvojë në lidhje me administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit filmik. Këto ishin me shumë vlerë për ne.

Por !!!…Ne u bëmë antarë të Federatës vetëm për formë. Lidhjet me të qëndruan për një kohë të gjatë të ngrira. Ata na dërgonin raportet vjetore të miratuara nga Kongreset që bëheshin çdo vit në vende të ndryshme të botës. Na kërkonin informacione për fondin tonë, për gjendjen teknike të tij. Na bënin propozime për bashkëpunim, shkëmbim reciprok fondesh me interes të përbashkët, na bënin ftesa gratis për specializim kuadrosh teknike nëpër arkivat evropiane etj. Por ne e kishnim të vështirë. Që të përgjigjeshe duhej të merrje aprovimin nga lart, dhe rruga ishte

tepër e gjatë dhe e pa shpresë. Kërkesat tona duhej të kalonin drejtorisë së Arteve, zv/ministrit, ministrit, prej andej në disa hallka të Ministrisë së Jashtëme dhe prej andej vazhdonte maratona në sektorin përkatës të Kryeministrisë deri te miratimi i zv/kryeministrit dhe vijonte në sektorët e aparatit të Komitetit Qëndror dhe sekretari i K.Q për propagandën që jepte mendimin përfundimtar.

Federata na bënte thirrje e ftesa për specializim kuadri teknik restaurator e kinoarkivist, por ishte e vështirë të çaje. Gjithnjë "politika në plan të parë" dhe ato ishin vende "kapitaliste e revizioniste". *Kë do dërgojmë? !, janë vende kapitaliste ku veprojnë agjenturat kundër vendit tone-* ishte refreni i përgjigjeve verbale !!…

Kështu që bursat digjeshin. Ata mërziteshin dhe çuditeshin me heshtjen tonë. Na bënin çdo vit ftesa për të marrë pjesë në Kongreset e Federatës, në simpoziume historike ose teknike për mirëmbajtjen e restaurimin e fondeve filmike arkivore, dhe ne nuk merrnim pjesë.

Lidhjet tona me Federatën mbetën për një kohë të gjatë formale dhe ishin kufizuar thjesht në pagesën e kuotës vjetore të antarësisë dhe në raportimet vjetore të filtruara që dërgonim për gjendjen teknike të fondit, hyrjet e reja, masat e mirëmbajtjes që ishin tepër të kufizuara ej. Harrijti puna që Sekretari i Përgjithëshëm i Federatës Jack Ledoux disa herë të na kërkonte përse nuk marrim pjesë në asnjë veprimtari kur ishin në interesin tonë dhe, më vonë, një kërkesë të tillë e bëri edhe vetë Presidenti i FIAF. Ai më në fund na kërkoi prej nga vareshim që të shkruanin vetë organeve tona eprore. Ata nuk e kuptonin sistemin tonë!

Edhe pak leteratyrë që vinte nuk shfrytëzohej. Punonjësit e arkivit nuk dinin gjuhë. Unë në atë kohë arkivin e kisha një mbingarkesë. Fillimisht isha tepër i garkuar me teknikën dhe teknologjinë e prodhimit dhe me kinematë e rretheve, me organizimin e prodhimit dhe të proçesit teknologjik si kryeinxhiner

që isha. Në këtë kohë Arkivi i Filmit varej direkt nga drejtori i Kinostudios (1965-1973).

Në vitin 1966 u shkarkova si kryeinxhiner/edhe kjo ka historinë e saj/ dhe u ngarkova të drejtoja sektorin e kinemave ku zinte një vend të madh ngarkesa e furnizimit me filma të rreth 450 qëndrave kinematografike (stacionare e lëvizëse) që vepronin në të gjithë Republikën, me mungesat e shumta të lëndës së parë dhe kopjet e filmave 35 e 16m/m, me mungesën e premierave, me gjendjen e rëndë teknike të shumë kinemave dhe mungesën e fondeve për porositjen e pjesëve të ndërrimit për to, me procesin e përkthimit dhe subtitrimit e redaktimit të filmave që ishte një punë e vështirë e gjithmonë me rreziqe.

Mbingarkesa dhe mungesa e përvojës në këtë sektor të ri për mua u rëndua nga shumë faktorë të tjerë politikë, ideologjikë, ekonomikë e shoqërorë. Kohë nuk kisha të merresha me kërkime, prandaj për një kohë e ndërpreva veprimtarinë kërkimore.

Fillimet e punës kërkimore

Shkrimi im botuar në gazetën "Zëri i Popullit" më 12 tetor 1972 me titull "*Do të na duhet shumë Film Arkiva*",bëri jehonë në publik dhe shkaktoi një tronditje edhe në qarqet zyrtare deri në organet më të larta të aparatit shtetëror.Në atë shkrim unë shprehja shqetësimin se fondi filmik arkivor ruhej në kushte jashtëzakonisht të këqija dhe nga çasti në çast ishte në rrezik për tu asgjësuar si nga kushtet e vështira teknike të ruajtjes ashtu edhe nga rreziku direkt i zjarrit dhe keqbërësit dhe bëja paralajmërimin se kjo do të ishte një fatkeqësi e madhe kombëtare prandaj duhej të merreshin masa të shpejta derisa të mos ishte tepër vonë.Në këtë shkrim unë jepja edhe idetë e mija se Arkivi i filmit nuk duhej të ishte

thjesht një depo ruajtje por fondi duhej ti nënështrohej proceve të mirëmbajtjes dhe reastaurimit sikurse edhe të krijimit të një aparati informativ shkencor në mënyrë që të shërbente edhe si një qëndër studimore shkencore që të kishte akses edhe për studjuesit,kineastët sikurse edhe për publikun e gjërë për përhapjen e kulturës kinematografike.Ky shkrim bëri që të merreshin disa masa të shpejta për sigurimin e fondit filmik,u dhanë porosi të fillohesh puna për ndërtimin e Arkivit të ri të filmit,u bë një rregullore e brëndëshme e miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Kulturës dhe mua më thirrën në aparatin e Këshillit të Ministrave te Zv/ Kryeministri Xh.Spahiu i cili më përgëzoi për problemet serioze që kisha ngritur në artikullin t'im.Kjo u bë gjithashtu shkas që në gushtin e vitit 1973 unë të tranferohesha nga sektori i kinemave si drejtor i Arkivit Shtetëror të Filmit.Emërimi në arkivë më vuri para sfidave të mëdha që duhej të përballoja.Por ky emërim më dha edhe kurajo që t'i kushtohesha më shumë punës sime kërkimore në gjurmë të historisë së filmit dhe kinemasë në Shqipëri.

Fillova kërkimet në organet e ndryshme të shtypit të periudhës 1900-1944. Ishte një punë e vështirë, një fushë e pa eksploruar nga unë më parë. Nuk kisha përvojë me skedimin e informacionit që gjeja dhe i mbaja shënimet në fletore ose fletë të veçanta që më vonë më krijuan shumë vështirësi në sistemimin dhe grupimin e informaionit të gjetur. Por vështirësitë më të mëdha më dolën në punën kërkimore.

Në atë kohë gjithë shtypi i paraçlirimit ishte i rezervuar, sekret dhe tepër sekret që nuk i lejohesh kujtdo për ta lexuar, duhej të injorohesh çdo gjë që kishte të bënte me te kaluarën. Revistat dhe gazetat jepeshin shumë të rezervuara dhe vetëm me lejen e drejtorit të bibliotekës mbasi të ishe pajisur me një vërtetim të posaçëm nga drejtuesi i institucionit ku punoje ku duhej të precizohesh qëllimi i shfrytëzimit dhe çdo gjë duhej të ishte nën

kontroll. Edhe duke e patur këtë autorizim shpesh herë nuk të jepej matëriali që kërkoje nën pretekste të ndryshme ose duhej të prisje një kohë të gjatë deri sa të nxirreshin gazetat dhe revistat nga fondi i bibliotekës.

Vështirësia tjetër, jo e vogël, ishte koha. Nga viti 1973 punoja dhe isha tepër i angazhuar me problemet e organizimit të Arkivit Shtetëror të Filmit dhe vënien e tij mbi baza shkencore. Mungonte çdo përvojë, punonjësit ishin pa kualifikim në këtë fushë dhe shkolla e tyre e vetme ishte përvoja ime, njohuritë e mija. Të gjithë prisnin nga unë tu tregoja se çduhej bërë dhe si duhej bërë.

Pra unë duhej që çdo gjë të mësoja më parë ta bëja vetë që të kisha mundësi tu kërkoja vartësve dhe kolegëve të mi se çduhej të bënin. U ndesha me probleme nga më të ndryshmet që nga ato teknike e deri në punë të mirëfillta kërkimore e shkencore. Duhej mbi të gjitha të ruhej e mirëmbahej fondi i filmave, duhej përcaktuar rregulla rigoroze për ruajtjen, shfrytëzimin dhe restaurimin e tij. Ishin probleme që i takonin fushës së kimisë, kishin të bënin me celuloidin, ruajtjen e parametrave dhe kushtet optimale të magazinimit etj pra duhej të njihja më gjërë në fushën e teknollogjisë të prodhimit, ruajtjes së tij në kushte sa më optimale. Kishte probleme të temperaturave dhe lagështisë optimale të ruajtjes në depo që kishin të bënin me pajisje të sofistikuara elektromekanike dhe elektronike si kondicionerë e pompa për heqjen e lagështisë, filtra të ndryshme kimike dhe mekanike për pastrimin e ajrit, sisteme të sinjalizimit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe keq-bërësit etj. Dhe këto duhej ti mësoja vetë më parë, duhej të lexoja.

Përveç të tjerave isha në përgatitje të programit, projektit teknologjik dhe projektimit të arkivit të ri të filmave të mbështetur në koncepte bashkëkohore. Dëshira dhe pasioni nuk më mungonin, isha këmbëngulës, punën e kisha me pasion dhe fondin arkivor filmik e vlerësoja shumë si një pasuri e madhe kulturore që do tu

flasë brezave. Prandaj studjoja shumë, bile deri natën vonë pa e njohur lodhjen.Sidoqoftë kjo ishte një mbingarkesë që do të sillte pasoja më vonë në shëndetin tim.

Paralelisht më duhej të ndërtoja një aparat informativ shkencor, duheshin organizuar e sistemuar skedarët, kartelat bazë shkencore e teknike, duhej grumbulluar gjithë informacioni i shkruar dhe fotografitë, objektet me synimin për ngritjen e muzeut të kinemasë dhe bibliotekën shkencore të saj. Duhej filluar me hartimin e tregusve, filmografive, duhej filluar me kërkime dhe punë studimore. Jo se isha njeri i lokaleve, por nga kjo mbingarkesë hoqa dorë nga çdo llojë kohe të lirë e lokal.

Një pengesë tjetër e madhe ishte edhe xhelozia dhe dashakeqësia e disa mediokrëve që shkonin deri në drejtorinë e kinostudios, që shqetësoheshin dhe përgojonin çdo lëvizje timen jashtë studios duke e maskuar me termin se unë shfrytëzoja postin dhe largohesha për tu marrë me punë personale, ndërsa unë shkoja në bibliotekë dhe ngrija mbi tavolinë duke kërkuar çdo informacion që kishte të bënte me filmat e xhiruar në Shqipëri ose të shfaqur në të kaluarën, ngritjen e kinemave të para etj. Kur shkoja në bibliotekë punoja në tension të trefishtë se kisha shumë punë për të bërë në arkivë, se mungesa ime bëhej objekt intrigash e thashethemesh dhe a do të gjeja informacionin e duhur që interesohesha. Për drejtorin e kinostudios nga unë varesha ishte më mirë të qëndroja në kinostudio, qoftë edhe duke pirë raki në klubin e saj, sesa të shkoja në bibliotekë për tu marrë me punë kërkimore. Çdo gjë e masnin me kutin dhe veset e tyre.

Burimi i marrjes nëpër gojë nga ana e thashethemexhinjve nuk ishte vetëm dhe kryesisht xhelozia dhe paftësia, dembelizmi i tyre për tu marrë me punë të tilla.Ajo e kishte burimin tek ata njerëz përkrahës të ish drejtorit të mëparshëm i cili ishte pushuar nga puna pas një mbledhjeje të gjatë 7 ditore sajë denoncimeve dhe problemeve parimore që kisha ngritur unë për vite me radhë

në organizatën e partisë dhe kolektivin e kinostudios për të mbasi kishte ngritur një rrjet agjenturor dhe me intriga e përkrahje të pa-principta individëve dhe grupeve të ndryshme kishte futur intrigën dhe përçarjen.Ata kërkonin revansh dhe përpiqeshin të më pengonin në çdo mënyrë dhe të gjenin argumenta për t'u hakmarrë si ish servila të drejtorit të pushuar.Pra bëja një punë kërkimore me tension të shumfishtë dhe mbi të gjitha në ankthin a do kisha rezultate, a do zbuloja ndonjë dokument sado të thjeshtë, mbi fillimet e filmit dhe të kinemasë në Shqipëri dhe ndieja një çlodhje dhe gëzim të papërshkruar që më bënte të harroja çdo lodhje kur zbuloja ndonjë dokument të tillë.

Kur gjeja kohë të lirë punoja në bibliotekë,veçanërisht mbas dite, edhe 7-8 orë rresht pa u ngritur nga tavolina. Më ngrinte qafa. Studjuesit e tjerë bënin një punë sistematike mbas 1-2 orëve ngriheshin, pinin një cigare ose kafe, merrnin ajër, ndërsa unë duhej të shfrytëzoja çdo minutë se më prisnin, më kërkonin, shqetësoheshin ku është, ku ka vajtur, kërcisnin telefonat, vinin kontrollet për të parë në se isha në bibliotekë.

Me kalimin e kohës m'u bë tepër e vështirë puna kërkimore. U shfaqën fazat e para të iscemisë cerebrale prandaj u detyrova që herë pas here të dilja nga biblioteka për të pirë një kafe në hotel "*Tirana*", jo se isha terjaqi dhe se kisha para, por me atë rast merrja pak ajër të pastër. Mësova të pija një kafe të detyruar. Megjithatë gjëndja shëndetësore u keqësua, u bëra objekt i nervologëve, prandaj ishte e domosdoshme të ndërroja metodën e punës, ti kushtohesha pak edhe punës fizike. Shtëpinë e kisha me oborr dhe një copë kopsht prandaj fillova ta punoj atë në orët e mbasditës dhe të mbillja hardhi, të sistemoj oborrin. Kjo më ndihmoi shumë për të thyer monotonin. Gjelbërimi që u krijua më veproi pozitivisht nga ana psikologjike, më lehtësoi punën kërkimore. U nisa me durimin, këmbënguljen, pasionin dhe përkushtimin por edhe me një ndjenjë patriotike, për të lënë një trashëgimi. Çdo

njeri duhet të verë një gur në themelet e kombit, "*njeriu që nuk ka lënë gjurmë në jetë, është e kotë që ka jetuar, i është bërë vetëm një barrë shoqërisë*". Atdheu kërkon përkushtimin e të gjithëve.

Por edhe unë isha një krijesë e kohës kur jetoja, edhe unë isha rritur dhe edukuar me psikologjinë dhe propagandën dashakeqëse se çdo gjë në Shqipëri lindi dhe u krijua mbas çlirimit, kur erdhi në fuqi Partia Komuniste dhe Enver Hoxha. Kjo psikologji të bënte pesimist dhe të vinte në dyshim a mund të kishte trashëgimi edhe në fushën e filmit dhe të kinemasë kur Shqipëria vuante edhe për bukën e gojës?.

Kjo më shqetësonte. A do kisha rezultate, a do e justifikoja gjithë atë punë kolosale, a do tu jepja përgjigjen e merituar dashakeqve, intrigantëve, parazitëve, dembelave dhe mbi të gjitha a do të zbuloja dhe krijoja një traditë në një fushë të pa-shkelur. Kjo u bë edhe motoja kryesore që më jepte shpresa dhe më shtonte forcat për një punë këmbëngulëse.

Puna kërkimore në shtypin periodik dhe të përditëshëm filloi të më bindëte përherë e më tepër se nuk mund të ngrihet shtëpia pa themele, se çdo brez vë një tullë në ngritjen e saj dhe se propaganda që, çdo gjë lindi më 1945, ishte vetëm një demagogji për të hyjnizuar E.Hoxhën dhe regjimin që ai drejtonte me dorë të fortë. Kjo ishte një propagandë në themel antikombëtare se mohonte çdo llojë trashëgimie kulturore, artistike, mohonte figura të shquara të kombit sepse kishin lindur në një epokë tjetër dhe nuk i kishin shërbyer Partisë dhe Komunizmit. Prandaj u mohuan Fishta, Konica e figura të tjera madhore të se kaluarës.

Duke shfletuar shtypin pashë se nuk kanë munguar asnjëherë kombit tonë figurat e tij të shquara në të gjitha fushat: shkrimtarë, gazetarë, arsimtarë dhe intelektualë në të gjitha fushat Këto zbulime më dhanë energji dhe hov, më shtuan krenarinë kombëtare më lehtësuan lodhjen.

Si të mos ishe krenar kur lexoj që në vitin 1913 në "*Shqypnija e re*" të Shkodrës ku Hil Mosi dhe Risto Siliqi bënin thirrje për ngritjen e një teatri kombëtar duke e vlerësuar teatrin një shkollë të dytë për kombin. Dhe flitet për vitin 1913 kur analfabetizmi ishte masiv dhe ende nuk kishte një shtet shqiptar. Si mund të mos ndjeheshe krenar kur zbuloje se vëllezërit shqiptarë Manaqi u bënë pishtarët e parë të kinematografisë në trevat ballkanike duke xhiruar filmin "*Tjerrëset*" që në vitin 1905. Si mund të mos ndiheshe krenar për studion fotografike "*Marubi*" që e filloi veprimtarinë e saj që në vitet 50-të të shekullit të 19-të d.m.th vetëm pak vjet pas lindjes së fotografisë. Si mos ndjeheshe krenar kur një nga figurat poliedrike të kombit, Kolë Idromeno, çeli studion e tij fotografike "*Dritëshkronja Idromeno*" që në fillim të viteve 80-të të shekullit 19-të dhe që ishte i pari që filloi edhe shfaqjen e filmave në Shkodër në klubin "Gjuha shqipe" qysh në vitin 1908.

Të gjitha këto dhe shumë të tjera dëshmonin për etjen e madhe të shqiptarëve për progres, kulturë e përparim, dëshmonin për përqafimin e çdo shpikjeje të njerëzimit. Të gjitha këto nga njëra anë më stimuluan dhe u bënë burim frymëzimi dhe nga ana tjetër më bindën për fallsitetin e propagandës bajate të regjimit që shpallnin krijimin e botës me ardhjen e tyre në fuqi.

Një përfundim tjetër ishte se, në kundërshtim me propagandën që bëhesh, shtypi ishte i hapur,i lirë dhe progresist në vitet 20-të e 30-të të shekullit të kaluar,ai ka lozur një rol përgjithësisht përparimtar në emancipimin e kombit. Po kështu në faqet e shtypit pashë rolin e madh të arsimtarëve në edukimin e brezit të ri, veprimtarinë e gjithanëshme të tyre për përparim dhe emancipim, luftën e tyre të vendosur për progres shoqëror, nisiator të çdo lëvizjeje emancipuese.

Ky rol i gazetarëve, arsimtarëve dhe intelektualëve të kombit u zbulua hap pas hapi në punën time kërkimore nëpërmjet shtypit,

më vonë edhe nëpërmjet dokumentave arkivore. Edhe filmi u kuptua qysh në fillim si një mjet përparimi, progresi dhe emancipimi dhe jo thjesht si një zbavitje. Kështu H.Mosi dhe R.Siliqi shkruanin në gazetën e tyre më 1912:

"*A e din ala se n'shpië të Kol Arsenit (Idromenos-A.H) asht nji dugaj që i thonë Grand Kino-Skioptiko?. Aty asht nji vend ku qiten t'faquna t'bukra e t'dobishme…nuk asht vetëm nji vend qejfit por edhe nji vend ku mundet nieri me nxanë ndonjisend…*"(Shqypnie e re, 1913, Nr.6, 20 korrik).

Kështu shkruante një gazetë që u bënte thirrje Bashkive të ngrinin një kinema të vogël ose të madhe:

."*..Të gjitha Bashkitë lypsen që qytetin e tyre ta pajisin me një kinema të vogël ose të madhe, sipas fuqisë së qytetit, dhe me cdo mjet të mundëshem të ngjallin në shpirtin e popullit, dëshirën për t'u zbavitur në këto lokale, se vetëm kështu mund të luftohen mejhanetë dhe kumarhanetë…"*(Besa, 1933)

Dhjetra e qindra artikuj bënin homazh figurave të shquara të interpretimit dhe regjisë filmike botërore si Çaplin, Pabst, Kler, Renuar, Garbo, Valentino etj etj. Figura të shquara të kombit bënin thirrje dhe propagandonin filmat e realizuara të mbështetur në veprat letrare të kollosëve të letërsisë botërore si:Gete, Flobert, Remark, Hygo, Shekspir, Dikens, Pushkin, Gogol, Gorki, etj ose ekranizimet e operetave dhe operave të kompozitorëve të mëdhenj si: Shopen, Verdi, Shtraus, Shubert, etj.

Nëpërmjet shtypit zbulova jehonën e madhe dhe mikpritjen që ka gjetur filmi në Shqipëri, ndihmesën e tij të fuqishme në progresin dhe emancipimin e vendit, ndihmesën që kanë dhënë kinematë në gjallërimin e jetës kulturore artistike, në lëvizjen artistike amatore, në edukimin muzikor, në dramaturgjinë kombëtare që sapo kishte hedhur hapat e para, në përgatitjen e një brezi të ri aktorësh të teatrit dhe posaçërisht në emancipimin e gruas shqiptare

për të cilat unë kam përgatitur një studim të veçantë.(*Ndikimi i Filmit në emancipimin e Kombit*)

Sa më thellë futesha në shtypin e kohës aqë më shumë befasohesha dhe entusiazmohesha, aqë më shumë shlodhesha dhe merrja energji të reja pas çdo zbulimi që bëja. Më entusiazmonin thirrjet e arsimtarëve për organizimin e shfaqjeve të filmave edukativë dhe pajisja me aparate e shkollave, përdorimi i filmit si një mjet konkretizimi i procesit mësimor në lëndët bazë të dijes ose zgjerimi i horizontit kulturor të nxënësve etj.Më entusiazmuan vlerësimet që u bëheshin figurave të shquara të kinemasë botërore ose propagandimi nga njerëz elitë të kulturës të filmave. Dhjetra e dhjetra artikuj për Ç.Çaplinin, G.Garbon, Zh.Mc Donaldin, Grifithin, Pabstin, Klerin, Renuarin, Basermanin F.Kortnerin, M.Shevalien, Zh.Gabenin etj, etj vërtetonin se njerzit tanë të kulturës dhe gjithë opinioni përparimtar vlerësonin çdo gjë progresiste dhe emancipuese ashtu sikurse edhe kritikonin shumë shfaqje të huaja negative e denigruese, degjeneruese që u shfaqën në disa filma me kriminalitet, filma të tmerrit, erotikë, filma që denigronin moralin njerëzor sikurse edhe artistë e regjisorë të koruptuar që denigronin vetë kinematografinë.

Ishte një punë kërkimore e lodhëshme dhe e gjerë. Vetëm në Bibliotekën Kombëtare shfletova rreth 220 organe të shtypit në rreth 380.000 faqe gazeta e revista përveç rreth 400 dosjeve të Arkivit Qëndror të Shtetit. Vetëm me fotografët dhe kineastët e parë në Ballkan, vëllezërit Manaqi, u mora gadi 4 vjet për të zbuluar origjinën dhe krijimtarinë e tyre. U mora me gjeografinë dhe hartat gjeografike të botuara nga francezët, gjermanët, italianët, turqit që nga mesjeta për të parë kujt i përkisnin krahinat dhe popullsia e fshatit dhe krahinave ku ata lindën. Studiova E.Çabejn për të parë rrënjët dhe mbrapashtesat e emrave dhe mbiemrave të tyre, u mora me folklorin dhe botimet e fillimeve të shekllit të 19-të në këtë fushë të S.Dines etj për të zbuluar origjinën e këngëve dhe

gojdhanave, u mora me historinë e krahinave të Sulit, Grebenesë, Mecovës, Konicës, Janinës ku ata lindën dhe u rritën, u mora me lidhjet familjare, miqësore dhe ekonomike të tyre me banorë e tregëtarë të ndryshëm etj.

E harrova familjen, e harrova vehten.

Dhe kur natën e vitit të ri 1984 isha harruar pas shkrimeve dhe ora po shkonte 22.00 më vjen bashkëshortja dhe më thotë të fillonim mbrëmjen u befasova kur në tavolinë ishin shtruar 4 pjata. Kur e pyeta i çuditur:

-Përse janë 4 pjata kur ne jemi vetëm dy? Ajo m'u përgjegj:

"*Janë dy pjata për vëllezërit Manaqi sepse ti ke 4 vjet që me ata po merresh!"*.

Ndjeva një farë keqardhje për të por edhe një respekt që me sjelljen e saj më ndihmonte mua duke i marrë punët e shtëpisë mbi vehte që unë të vazhdoja punën kërkimore. Ajo kish sakrifikuar daljet, vizitat, shëtitjet. Unë i isha mirënjohës sakrificës së saj, ndonse me vonesë prandaj edhe në faqen e parë të "*Enciklopedisë të Kinematografisë shqiptare*" që botova më vonë i kam bërë këtë kushtim:

Noit,
U lodhe duke pritur që unë të ngrihesha,
Të dilnim në vizita, ajër të pastër.
Unë heshtja, mendoja, shkruaja, harrohesha, premtoja.
Dhe ti, ndonëse e mërzitur,
Mollën, limonadën, biskotën, kafen
Nuk m'i ndave asnjëherë nga tavolina.
Më fal!

Nga kërkimet disa vjeçare zbulova gjëra interesante për historinë e filmit dhe kinemasë në Shqipëri që nga xhirimet e të huajve dhe shqiptarëve, shfaqjen dhe ngritjen e kinemave të para

etj. Nëpërmjet të shtypit të kohës gjeta se ishin xhiruar mjaft kronika dhe filma dokumentarë nga të huajt në trevat shqiptare si hyrja në kongresin e Manastirit/1908/ dhe manifestimet e shqiptarëve me këtë rast, Kongresi i Dibrës /1909/ xhirime të çetave patriotike të Çerçiz Topullit e M.Gramenos, nga veprimet luftarake të shqiptarëve dhe maqedonasve në "Lëvizjen e Ilindenit" /1903/, rite, zakone, kostume dhe valle popullore xhiruar nga vëllezërit Manaqi/1905-1913/ dhe shoqëria angleze Charls Urban Company, shpalljen e Hyrietit në Manastir /1908/, mbritjen e sultan Reshatit në Manastir /1911/, gjendjen e vendit pas Shpalljes së Pavarësisë dhe krimet e sërbve në inkursionin drejt Durrësit /1912-1914/, Rrethimin e Shkodrës dhe hyrjen e trupave malazeze atje /1913/, lufta për marrjen e Lezhës nga trupat austriohungareze /1914/, mbritjen e Princ Vidit dhe shpalljen e Durrësit kryeqytet /1914/, bombardimin e Durrësit dhe largimin e trupave të huaja më /1918/ , kronika nga Tirana, Berati, Kukësi, Malësia e madhe, pamje të qyteteve, tregjet, rite e zakone /1914-1926/ e shumë e shumë të tjera që i kam paraqitur hollësisht në librin tim "*Arti i shtatë në Shqipëri* –vëllimi i parë- botuar 1994/.

Veprimtaria ime u shtri nga puna e gjërë hulumtuese në Bibliotekën Kombëtare,të Korçës dhe Shkodrës ku shfeltova rreth 220 organe në rreth 380.000 faqe në harkun kohor 1900-1944,si dhe në Arkivin e shtetit,në korespondencë me shumë studiues nga Anglia,Austria,Italia, Hollanda, Franca etj si dhe kërkime direkte në disa arkiva dhe Institute Kinematografike evropiane në Austri,Gjermani,Itali,Danimarkë etj.

Mbështetur në këto kërkime shkrova një libër të titulluar provizorisht "*Fillimet e kinemasë në Shqipëri"* rreth 600 faqe mbi shfaqjet dhe xhirimet e filmave në Shqipëri nga viti 1897-1944,mbi figura shqiptare që kanë debutuar në kinematografinë botërore si A.Moisiu,K.Antoniu,Elena Qirici-balerinë dhe aktore e parë shqiptare e kinematografisë, regjisorin e parë shqiptar të

kinemasë Mihallaq Mone,xhirimet e disa filmave artistikë me tematikë shqiptare nga danezët,italianët etj duke filluar nga viti 1922,mbi xhiruesit e parë të filmave në trevat ballkanike vëllezërit shqiptarë Janaq dhe Miltiadh Manaqi(me origjinën dhe veprimtarinë e të cilëvet jam marrë gadi 4 vjet),mbi jehonën e shtypit dhe të mendimit përparimtar shqiptar mbi filmin,kinemanë dhe figurat e shquara të kinemasë botërore në vitet 1920-1930,mbi ndikimin e filmit dhe të kinemasë në jetën kulturore-artistike të vendit dhe në pregatitjen e një brezi aktorësh të teatrit,mbi ndikimin e filmit në emancipimin e gruas dhe përgjithësisht të shoqërisë shqiptare, në kulturën muzikore, mbi synimet dhe propagandën me anën e filmit nga italianët dhe gjermanët gjatë pushtimit fashist e nazist,mbi amatorët e parë të kinemasë në Shqipëri dhe xhirimet e tyre nga vitet 1927-28 etj.

Meqënëse ky ishte studimi i parë serioz dhe me pretendime vendosa që të tërhiqja mendimet e disa personaliteteve të larta të kulturës dhe artit,profesorë,akademikë, regjisorë, kritikë etj si Akademikëvet Bedri Dedja,Dhimitër Shuteriqi,kritikut Adriatik Kalluli,regjisorëve Dhimitër Anagnosti dhe Ylli Pepo, skenaristit dhe stujuesit Luan Rama,studjuesvet të artit. Capajev Gjokutaj dhe A.Myftiu etj.Pata vlerësime mjaft inkurajuese, disa edhe me superlative.

Kështu Akademiku B.Dedja shkruan:

Meritat e punimit janë shumëplanëshe si:Paraqitet historia e xhirimeve filmike në Shqipëri ç'ka është me shumë interes për historinë tonë kombëtare në përgjithësi si dhe në degët e tjera të shkencave historike e kulturës popullore,për historinë e arsimit,për historinë e kulturës dhe të artit,etnografinë,gjeografinë,psikologjinë sociale etj.,trajton probleme të historisë së kinematografisë botërore në mardhënie me vendin tonë,ndikimin që ka ushtruar ajo dhe luftën që i kanë bërë populli dhe forcat përparimtare invazionit

kinematografik reaksionar botëror e,veçanërisht fashist, autori jep gjykime të pjekura për rrymat kinematografike botërore,për aktorët,regjisorët,operatorët etj,të cilat përfaqësojnë një ndihmesë origjinale për historinë e kinematografisë botërore .Në studim është shfrytëzuar një matërial jashtëzakonisht i bollshëm teorik,arkivor,nga shtypi ynë si dhe nga burime të huaja.Ngë kjo pikpamje është bërë një punë kolosale e cila meriton konsideratat dhe lavdërimet më të larta.Ngë pikpamja e stilit,studimi,në përgjithësi,është shkruar bukur dhe në formë tërheqëse.Ai nuk të lë për asnjë minut indiferent.Dhe duke u nisur nga këto vlerësime ai e propozon reçenën e tij që të merret parasysh për botim nga Qëndra e Studimit të Arteve e Akademisë së Shkencave.

Profesor Dh.Shuteriqi ndër të tjera thekson:

Kapitujt e këtij punimi të gjatë janë përgjithësisht të pasur,na informojnë në mënyrë dokumentuese.Po do të thoshim se kapitulli i pestë është veçanërisht interesant nga disa anë,sepse na zbulon qëndrimin ndaj këtij arti në Shqipëri.Tjetër herë nuk kanë qënë evidentuar këto fakte që kanë të bëjnë me zhvillimin e mendimit estetik ndër ne,të njohur thuajse vetëm përmes qëndrimit ndaj letërsisë.Jepen kështu dokumente interesantë,duke qëmtuar në shtypin shqiptar,veçanërisht në atë të viteve 30,kur filmit i është bërë një jehonë më e dukëshme në këtë shtyp.Njerzit që shkruajnë nuk janë zakonisht njerëz sadopak të formuar si kritikë,por,më se një herë,nuk janë pa egzigjenca ndaj artit dhe dijnë të mbajnë më se një herë qëndrime realiste dhe me vlerë,sidomos kur gjykojnë mbi rolin e filmit mbi spektatorët tanë.Del në atë kapitull mendimi përparimtar,që arrin të depërtojë edhe në shtypin reaksionar,që ishte në pjesën dërmuese shtypi i kohës tek ne,sidomos në vitet 30 e në atë të pushtimit fashist.Me interes të vaçantë është çka qëmtohet e paraqitet

mbi lëvizjen nacionalçlirimtare dhe kinemanë e filmin (kapitulli IX)….Në përgjithësi mendoj se kemi të bëjmë më një punim që ka vlera njohëse,punim që në pasuron mbi historinë e arteve në Shqipëri,-ndonse,siç dihet,kinematografi shqiptare s'kemi ende në këtë fazë historike si krijimtari të mirëfilltë.

Mendime pak a shumë të tilla kanë dhënë edhe Luan Rama (në atë kohë udhëheqës artistik i kinostudios dhe skenarist).Mendimet e tij të plota janë dhënë në parathënien e librit t'im të botuar "*Arti i shtatë në Shqipëri*"që përban vetëm disa nga kapitujt e këtij studimi, në të njëjtën mënyrë është shprehur edhe kritiku Adriatik Kallulli i cili ka qënë edhe redaktori i librit të përmendur më lart sikurse dhe Abdurrahim Myftiu, Ylli Pepo etj. Por ai që bëri një studim të hollësishëm ishte Prof.Dh.Shuteriqi i cili një ditë më mori në telefon dhe kërkoi të pinim një kafe.Shkuam në Hotel "Tirana".Duke pirë kafe ai po më shikonte me vrejtje dhe pa pritur më tha: -

E kam lexuar dhe studjuar me hollësi, kam jetuar nëpërmjet leximit vitet 30-të.Në veçanti më ka pëlqyer kapitulli i pestë që flet për shtypin dhe mendimin përparimtar për filmin dhe kinemanë në vitet 20-të e 30-të.Janë përshkruar me hollësi dhe realisht, Ndaloi pak dhe m'u drejtua përsëri:

- Po do thyesh kokën mor djalë!.

U çudita nga kjo fjalë dhe pas një pauze e pyeta:

-Përse profesor!?

-Po të them përsëri se do thyhesh kokën.

Por unë çdo gjë e kam të dokumentuar,kam vënë në fund shënime dhe citimet e shtypit ose dokumentave të Arkivit të Shtetit.Pra kam thënë të vërtetën.

-Pikërisht se ke thënë të vërtetën po ta përsëris se do thyhesh kokën.

I çuditur përsëri e pyeta:

-Po pse profesor.?

Më shikoi edhe një herë me vëmëndje dhe më tha:
-Pse nuk e nuhat situatën?.Cdo gjë ka lindur pas vitit 1944 kur erdhi Partia.Nuk mund të ketë trashëgimi pozitive në të kaluarën dhe ti nxjerr aty edhe vlera të së kaluarës,të shtypit, gazetarëve disa vendime të Ministrisë së Arsimit etj.Këto mendime që sigurisht nuk i vuri në reçencën e tij të shkruar.

Kjo vrejtje më vuri shumë në siklet dhe nuk dija si ti trajtoja ngjarjet.Më në fund, kur e paraqita për botim librin, e gjeta "thembrën e Akilit".Mbeshtetur në dokumentet gjeta se në fillim të viteve 1930 si ministër i arsimit kishte qënë për një kohë Hil Mosi dhe drejtor i arsimit të mesëm Aleksandër Xhuvani.Prandaj, me vend e pa vend, në çdo 3-4 faqe të studimit kur flitesh për ndonjë fenomen pozitiv përmendja faktin :"..të mos harrojmë se në këtë periudhë kanë punuar në ministri H.Mosi dhe A.Xhuvani"..figura këto të vlerësuara edhe në atë periudhë.

Mendimet e këtyre intelektualëve nga më të njohurit të kohës nga njëra anë më inkurajuan,por më vunë edhe para përgjegjësisë për ta rishikuar krejtësisht studimin tim në bazë edhe të disa vrejtjeve që ata më bënë.

Në vitin 1980 u botua revista kulturore-artistike "*Skena dhe Ekrani*",një revistë që hapi një dritare të re në shtypin shqiptar.Kryeredaktori,poeti Ndoc Gjetja, kërkoi që të bëja një shkrim mbi fillimet e kinemasë në Shqipëri.Ndonse nuk e kisha përfunduar ende punën time kërkimore dhe kisha ende gjëra të paqarta,pranova të bëja këtë shkrim se doja edhe të shikoja reagimin publik dhe të qarqeve kulturore-artistike ndaj punës sime.Shkrimi i parë u botua në këtë revistë me titull:"*Historia e kinemasë në Shqipëri*" (SE,1982,nr.3,f.54-57) dhe në numurin pasardhës shkrimin "*Xhirimet e filmave në Shqipëri nga të huajt,1908-1944"*(SE,1982,nr.4,f.36-39) e më tej.Këto shkrime u pritën shumë ngrohtë dhe me interes në të gjitha qarqet prandaj kjo më dha kurajo për të vazhduar më me pasion punën time kërkimore.

Ky libër u fut i plotë në procesin e botimit në vitin 1987 por u harrijt të botohet në vitin 1994 vetëm një vëllim me titullin "*Arti i shtatë në Shqipëri*" që përmban disa kapituj si shfaqjen dhe ngritjen e kinemave të para në Shqipëri,Xhirimet e filmave në Shqipëri nga kineastë të huaj,vëllezërit Manaqi,amatorë shqiptarë,filmin dhe kinemanë gjatë pushtimit fashist e nazist etj.Pjesa tjetër nuk është botuar ende për vështirësi financiare.

Drejt arkivave kinematografike evropiane

Të gjitha këto u nxorrën nga njoftime të shkurtëra në gazetat e midis kronikave të luftës. Shqipëria ishte në luftra të pandërprera nga fillimi i shekullit të kaluar.Kryengritjet e mëdha kundër pushtimit osman /1909-1912/, Luftrat ballkanike /1912-13/ Lufta e parë Botërore /1914-18/,etj ishin trajtuar në kronika të ndryshme kinematografike.

Por duhej të vërtetoheshin, të dokumentoheshin kush i kish xhiruar, kineastë dhe shoqëri filmike. Për ketë nuk mjaftonin kërkimet në shtypin dhe arkivat e vëndit. Duhej të krijoheshin lidhje me arkivat dhe Institucionet kinematografike evropiane, gjë që ishte shumë e vështirë në atë kohë. Nuk ishte thjesht krijimi i garancisë sime se isha në gjëndje të merresha me kërkime dhe hulumtime në arkivat evropiane por kishte kryesisht pengesa politike dhe ideologjike.

Shqipëria gradualisht po priste çdo kontakt me botën, shkoi drejt vetizolimit total, drejt mohimit të çdo kulture. U pengua çdo leteraturë. Edhe ajo që dërgohej institucioneve kulturore-artistike e shkencore nuk u dorëzohej dhe ose digjej ose mbahej e izoluar.

Komunikimi zyrtar me institucione evropiane ishte tepër i vështirë, kalonte nëpërmjet shumë hallkave të miratimit për të dërguar vetëm një letër, një maratonë e gjatë që shkonte 6 muaj e më tepër dhe të shumtën e rasteve nuk miratohej.

Nga veprimtaria ime e gjatë në kinostudio kisha krijuar një farë kredibiliteti dhe garancie. Kjo dhe njohjet e mija me disa kuadro të ministrisë Kulturës dhe Ministrisë së Jashtëme, natyra ime këmbëngulëse dhe mundësitë që u krijuan mbas riorganizimit të Arkivit Shtetëror të Filmit bënë të mundur të çaheshin barrierat. Shkrimi im në Zëri i Popullit "*Do të na duhet shumë film arkiva*" /12 nëntor, 1972/ këmbëngulja dhe argumentimi i vazhdueshëm për vlerat e dokumentave filmike të së kaluarës dhe për rëndësinë e lidhjeve me arkivat filmike të vendeve të tjera për të marrë përvojë për vënien e gjithë punës arkivore mbi baza shkencore etj, bënë punën e tyre, krijuan një imazh të qartë të seriozitetit me të cilën unë këmbëngulja për pasurimin e fondit filmik kombëtar me dokumente të rëndësishme të fillimit të shekullit.

Dhe më në fund u ça akulli,u miratua pjesëmarrja në Kongresin Ndërkombëtar të Arkivave të Filmave që u zhvillua në Rapallo të Italisë në maj 1981 si dhe për të filluar një punë kërkimore në disa arkiva italiane në Torino, Milano, Romë. Kjo ishte një ngjarje e madhe për mua se më në fund do kisha mundësinë ta shtrija veprimtarinë tonë dhe kisha shpresa të mëdha për një punë të suksesëshme.Këtë besim ma jepte puna ime e gjërë që kisha bërë gadi 16 vjet /1965-1981/. Kjo ishte edhe një sukses për Arkivin, kinematografinë dhe televizionin shqiptar, kjo do të ishte një ndihmë edhe për skenaristët dhe regjisorët që do ti përdornin këto matëriale në realizimin e filmave të tyre.

Këto kërkime dhe ato që do të bëja më vonë në arkivat austriake dhe gjermane, për të cilat do të flasim në kapitujt që vijojnë, si dhe një korespondencë e dendur me studiues dhe institucione kinematografike evropiane do të jepnin frutin e tyre.

Për të bërë më të besushme veprimtarinë time kërkimore dhe për të dhënë garanci më të mëdha për vazhdimin e kërkimeve në arkivat e huaja vendosa të publikoja një pjesë të veprimtarisë time. Më e përshtatëshmja ishte revista "*Skena dhe ekrani*" që u çel në vitin 1980 dhe që hapi një dritare të re në shtypin shqiptar. Shkrimet e mija bënë jehonë për kohën që u shkruan. Publikimi i disa rezultateve, korespondenca me shumë studjues dhe arkiva filmike evropiane si dhe puna këmbëngulëse kërkimore në disa arkiva në Itali, Austri, Gjermani rriti kredibilitetin dhe autoritetin tim në këtë fushë por edhe autoritetin e vetë Arkivit Shtetëror të Filmit i cili po shndrrohesh gradualisht në një institucion të rëndësishëm shkencor. Bile mund ta them se rëndësi më të madhe për mua kishte rritja e autoritetit të Arkivit Shtetëror të Filmit në mënyrë që ai të konsiderohesh një institucion i rëndësishëm studimoro-shkencor dhe të ndihmohesh me kuadër të aftë dhe fonde për të ecur në këtë rrugë..

Megjithatë vazhdonin pengesat. Një burokraci tepër e zgjatur për korespondencën me të huajt, një frikë për të dhënë përgjigje dhe mungesë përgjegjësie e kompetence. Këto ishin pengesa të pafalëshme që vështirësonin punën kërkimore prandaj vendosa përfundimisht ti sfidoj hallkat burokratike shtetërore dhe fillova korespondencën direkte personale me studjues dhe institute evropiane.

Tashmë isha bërë i njohur për ta dhe konsiderohesha i vetmi studjues në këtë fushë. Libri im "*Filmi Artistik Shqiptar*" që u botua pas shumë vështirësish dhe pengesash e justifikimesh nga më absurdet vetëm në vitin 1987 krijoi një kredibilitet dhe konsolidoi figurën time si studjues. Rreth 250 kopje të këtij libri ja u dërgova gjithë institucioneve studimore kinematografike dhe studjuesve në të gjitha skajet e globit dhe mora një sëri mesazhesh përgëzimi duke vlerësuar atë si një punë tepër serioze dhe një hulumtim i mirëfilltë shkencor. Ata më bënin edhe vrejtjen që të botohesh në

një gjuhë të huaj nga më të përdorëshmet ndërkombëtare dhe pati prej tyre /Gjermani, Angli/ që kërkonin edhe kopje personale.

Një studiues anglez /John Holstrom, antar i Institutit Britanik të Filmave dhe shef i redaksisë së muzikës në Radio Londra/ më shkruante:

-"*Ju uroj gjithë të mirat për progresin në punën tuaj kërkimore në fushën e historisë së kinemasë shqiptare.Do të ishte një punë me shumë vlerë,dhe unë shpresoj se do të botohet edhe në anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër të njohur gjerësisht*"."*Ta kam shumë zili që punon në një fushë të virgjër tek ju dhe në një vend të virgjër...por ju kini vështirësi të mëdha në punën kërkimore sepse nuk kini mundësinë e kontakteve me botën, nuk mund të vizitoni lirshëm këto institucione evropiane dhe botërore*….?

Me këtë studjues u bëra mik dhe ai, që po bënte një vepër tre vëllimshe me interpretimin e fëmijve në kinematografinë botërore dhe e kishin befasuar interpretimi i fëmijve tanë në filmat "*Lulëkuqet mbi mure*" dhe "*Beni ecën vetë*" të cilat i kish parë në Berlin kërkoi të vinte në Shqipëri për të pasuruar njohuritë e tij në këtë fushë. Por kërkesat e tij të vazhdueshme në gjuhët angleze, franceze dhe gjermane /duke menduar se ne nuk i njihnim ato gjuhë/ mbetën një zhgënjim se ne nuk mund të përgjigjeshim pa miratimin nga lart dhe ky miratim, ose nuk vinte kurrë ose vonohesh mbi një vit. Dhe ai i hipi avionit deri në Podgoricë dhe erdhi nga Hani i Hotit si turist. Kur ardhja e tij u bë fakt i kryer atëhere ministrja e Arsimit dhe Kulturës më autorizoi ta pres, ti shtroj një drekë dhe ta shoqëroj. Por kur u muar vesh se ai punonte në B.B.C në Londër *më bënë direkt paralajmërim duke thënë se B.B.C është agjenturë e imperializmit dhe derdh vrer kundër nesh.* Ndërsa unë i lodhur dhe i revoltuar nga procedurat, e humba durimin dhe ju thashë në mënyrë të prerë *se unë kam koresponduar dhe do korespondoj me studuesit evropianë të*

fushës në emër të shërbimit që dua ti bëj vendit tim, letrat i bëj të hapura nëpërmjet postës së rregullt, në se dyshoni për spiunazh, lexojini dhe më dënoni.

Për këto pengesa e akuzova direkt ministren e arsimit në një mbledhje që u bë në kinostudio ku ajo-sipas procedurave të kohës duhej të jepte llogari para institucioneve që drejtonte.

Studjuesi anglez J.Holstrom më hapi horizonte të reja kërkimore duke më lidhur me kolegë e miq të tij në Amsterdam, në Sondrio/ Itali/, Milano etj nga të cilët pata burime të rëndësishme informacioni për filma të xhiruar në Shqipëri.

Studjuesi gjerman Eberhard Spies,zëvëndësdrejtor i Institutit gjermanoperëndimor i artit filmik me qëndër në Frnakfurt më shkruante:

-"*Libri i mbrekullushëm mbi filmin shqiptar që më dërguat nuk ishte vetëm për mua një surprizë e këndëshme ndonse ishte botuar vetëm në gjuhën shqipe...Po pati mundësi të shpenzonit edhe një kopje tjetër për bibliotekën time personale,dhe në se do të ishte e mundur të ma dërgonit edhe me dedikim tuaj personal do të ju isha shumë i obliguar".*

* * *

Kërkime në Arkivat Kinematografike të Vienës

-Mbresa dhe shënime udhëtimi nga Austria-

Të nesërmen do të niseshim për në Austri për kërkime në arkivat kinematografike të Vienës.Atë natë nuk më zuri gjumi.Më kish pushtuar sikleti i pasionit dhe përgjegjësisë .Nuk ishte puna se do shkoja jashtë shtetit që ishte një gjë e rrallë për kohën dhe çdokush do të ma kishte zili, mbasi këtë ndjenjë e kisha provuar disa herë, por a do të mund të vërtetoja supozimet dhe a do të shpërblehesh ajo punë e lodhëshme shumëvjeçare plot pasion duke kërkuar në disa dhjetra mijra faqe të shtypit periodik dhe të përditëshëm shqiptar për të gjetur çfarë kanë xhiruar të huajt në vendin tonë në gjysmën e parë të shekullit.

Mëndja më shkonte te ai gëzim që kisha provuar kur në ndonjë njoftim gazete ose në ndonjë korespondencë zyrtare të dokumenteve të Arkivit Qëndror të Shtetit zbuloja se shoqëritë kinematografike"*SASCHA*"ose"*VIENER-UTOREN FILM*" kishin xhiruar Durrësin e vitit 1914 ose shpalljen e tij kryeqytet të Shqipërisë. A do t'i gjeja vallë këto kuadro të rralla! ? Herë mbushesha me besim dhe këtë besim ma jepte puna e gjatë kërkimore që kisha bërë në shtypin ose dokumentat e Arkivit të Shtetit, në botimet e huaja filmografike që kisha nundur të siguroja ose në takimet e korespondencat me drejtuesit e Arkivave Filmike Austriake.

Po shpejt ky besim më venitej kur më kujtohej takimi në Torino me drejtoreshën e Muzeut Kombëtar të Filmit Prof. Maria Adriana Prolo.Atje vajta plot shpresa.Në një libër të saj mbi

historinë e filmit italian pa zë,*(Storia del cinema muto italiano*,botim 1952) kisha gjetur se një shoqëri kinematografike torineze(Unitas) kish xhiruar më 1909 filmin "*Shqipëria rebelohet*", (Albania ribele)një dokument ky me vlera të mëdha historike e shkencore.Por kur unë- i bindur se filmi do të ishte në depot e Muzeut- e pyeta në se mund ta shikoja, ajo më zhgënjeu me një përgjigje pak sa të zgjatur :

- Eee, po ku ta gjej, zotëri?! Edhe unë do të desha ta kisha.

- Si është e mundur, zonjë ! Ju vetë e keni përmendur në librin tuaj !

- Ashtu është, por edhe unë e kam gjetur të shkruar nëpër revistat dhe gazetat e kohës. Sa filma të tillë që janë xhiruar dikur nuk gjenden. Ata janë shpërndarë në dhjetra e dhjetra arkiva italiane e shumica janë zhdukur nga mungesa e kujdesit. Në veçanti luftrat kanë asgjësuar shumë kronika e filma me vlerë.

Ajo ndërpreu bisedën për disa sekonda dhe pastaj tha me mallëngjim :

- Përveç kësaj, shumë drejtues fashistë të rangjeve të ndryshme edhe në këtë fushë kanë bërë krime të shëmtuara, ata e shkrinin filmin dhe i merrnin argjendin.

Unë, me Stavrin që më shoqëronte, shikuam njëri tjetrin në sy të zhgënjyer dhe të revoltuar nga krimi i gjerarkëve fashistë.

Kur më kujtohej kjo ngjarje më pushtonte një pesimizëm dhe mendoja me vete: A do të kem këtë përgjigje edhe në arkivat austriake ?

Në këto mendime e gdhiva duke u vërtitur nëpër krevat derisa në orën 4.30 të mëngjezit Astriti, shoferi i shkathët i kinostudios, i ra ziles së derës. Noi, si gjithmonë e kujdesëshme, i kish bërë gadi plaçkat dhe në pesë minuta u ndodhëm në udhëtim drejt Rinasit. Me ne udhëtonte edhe z. Teodor Laço, por ndërsa ndoshta ai po frymëzohej me pamjet mëngjezore, unë, duke shikuar

nga dritarja e "Tarpanit" fushat për rreth po mendoja për atë që më priste në Vienë. Nuk më pritesh sa të ngrihesh avioni.I kalova pa ndonjë interes formalitetet, ndarjet, megjithëse të them të drejtën-dy pikat e lotit në faqet e Noit kur u ndamë, më bënë të mallëngjehem.

Derisa dolëm mbi Adriatik nuk kaluan më shumë se 5 minuta. Isha gjithë emocione.

Tashmë po u largoheshim brigjeve tona dhe aeroplani që fluturonte mbi Adriatik po ngrihesh gjithmonë lart dhe doli mbi shtëllungat e bardha të reve që të bëjnë të jetosh në një botë fantastike.

Nga fluturimi i mëtejshëm nuk pata ndonjë ndjenjë të veçantë.Vendet që dukeshin poshtë, nëpërmjet të çarave të revet i kisha parë disa herë.Bile ndieja një qetësi shpirtërore që nuk do uleshim në Beograd.Kalimi nëpër Beograd dhe nëpër Jugosllavi gjithmonë më ka shqetësuar, mbasi kurdoherë atje më kanë ndodhur ngjarje të neveritëshme, vëzhgim i pandërprerë e ndjekje nga agjentët e UDB-së, kontrollet e pambaruara në aeroportet e Dubrovnikut dhe Beogradit, ndjekjet këmba këmbës me makina nga Titogradi në Beograd ose sjelljet e pa kulturuara të agjentëve të kufirit e doganierëve.Këto i kisha provuar më 1968, në prag të pushtimit të Çekoslovakisë ose në Majin e 1981 kur u sajua gënjeshtra e paskrupull e " hedhjes së bombës" në Ambasadën Jugosllave në Tiranë dhe kur, në prezencën tonë, agjentët e policisë sekrete merrnin në telefon ambasadën tonë të Beogradit dhe kërcënonin personelin se brenda 24 orëvet do t'i hidhnin në erë, ose që nuk donin të na lejonin të futeshim në hotel dhe nuk na jepnin biletë avioni për t'u larguar e shumë e shumë ngjarje të tjera që nga Marsi i vitit 1950 kur kam qënë për herë të parë në Beograd.

Sa më shumë i afroheshim Austrisë aqë më shumë më pushtonin emocionet.Nuk ishin këto emocione të befasimit për një vend të zhvilluar dhe me tradita të lashta kulturore, mbasi unë

kisha qënë në Vienë dhe ajo vërtet më kishte befasuar me madhështinë e saj, por ishin emocione për atë që më priste përpara.

Kur u futëm në tokën austriake menjëherë m'u kujtua ajo vajza që një vit më parë qëndronte në mes të pasazhit të aeroportit dhe u shiste gazeta udhëtarëve me atë buzëqeshjen e lehtë gjithë nur, por që brenda përmbante edhe pasigurinë e suksesit. Më kish bërë përshtypje ajo vajzë për korrektësinë shëmbëllore në kryerjen e detyrës së thjeshtë të saj.

Këtë kuadër, njohjen e parë me Austrinë e plotësonte edhe ajo muzika e Shtrausit që, e interpretuar aqë lehtë të ndjek në çdo hap.Qetësia e interpretimit të muzikës sikur i paralajmëron dëgjuesit të heshtin, të mos i prishin asaj bukurinë e frymëzimin, të mos i prishin qetësinë qytetit të lashtë, që ndonse si çdo qytet tjetër bashkëkohor ka marrë nga ritmi dhe tempi i kohës- ruan traditën e bukur të një vendi të qetë me pastërti shëmbëllore dhe korrektësi qytetare.Ajo që stonon në këtë qytet muze, ku çdo ndërtesë është një monument kulture, është zhurma e madhe e lumit të makinave që qarkullojnë pa ndërprerje që heret në mëngjez deri në mbrëmje vonë.

Në stacionin e trenit "Westbanhof" na priti Kujtimi-punonjës i Ambasadës, tek i cili binte në sy se fliste pak,por në ato fjalë të pakta grumbullonte përzëmërsinë e sinqeritetin, shpirtgjerësinë dhe mikpritjen shqiptare.

Nga Ambasada morëm menjëherë në telefon Muzeun Austriak të Filmave.Sekretarja na tha se ishin në dijeni dhe na prisnin. Më vonë do të provonim dashamirësinë dhe gadishmërinë për të na ndihmuar të kësaj sekretareje që herë pas herë e sfidonte gjermanishten time duke iu përgjigjur anglisht pyetjeve të mia dhe unë-megjithëse i njoh, por asnjërën nga këto gjuhë nuk i kam praktikuar në folje- e ndieja vehten më të lirshëm duke biseduar me të në një përzierje midis gjermanishtes dhe anglishtes.Ajo sekretare, gjatë të gjithë kohës që punova në atë Muze m'u bë si

një " varkë shpëtimi" për të komunikuar më lirshëm.Dhe në këtë çiltërsi ndikonte mirëkuptimi, gadishmëria dhe respekti reciprok.

Osterreichisches film musseum

Në orën e caktuar u takuam me zotin Konlehner, drejtorin e Muzeut, burrin e thjeshtë e simpatik, gjithnjë i qeshur dhe i gatshëm për të vënë çdo gjë në dispozicion.Atij i shkëlqente fytyra, sikur takohej me miq të vjetër. E vërteta është se unë njihesha me të mbasi isha takuar në dy Kongrese të Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmave, në Rapallo (Itali) dhe Vienë, por takimet kishin qënë shumë të shkurtëra.Na ofroi kafe, pije dhe na nxiste që të merrnim patjetër ndonjë send, por unë mezi prisja të futeshim në temë. Kolegen time, Marianthi Xhakon e shihja të preokupuar.Ne ia zbulonim njëri-tjetrit mendimet nëpërmjet syve.Porsa hoqa një herë në filxhanin e kafes, e hapa bisedën.

Ai dëgjonte i qetë, mbante ndonjë shënim, mendohej për ato që kërkonim.Pak më tej sekretarja ishte duke punuar mbi disa dosje, por siç dukej edhe ajo ndiqte me interes bisedën tonë. Nuk ishte thjesht sekretare por një kinoarkiviste që merresh me njohjen dhe përpunimin shkencor të dokumentacioneve.

Zoti Konlehner- pa u mendur gjatë- sapo unë mbarova bisedën, u ngrit dhe, pa dashur të shqetësojë sekretaren- shkoi në një raft mori një dosje të madhe dhe duke na e vënë atë përpara na tha:

-Ky është katallogu i kronikave kinematografike të xhiruara në vitet 1908-1938 për të cilat ju interesoheni.Unë kam parë të xhiruar vetëm një monolog të Aleksandër Moisiut në rolin e Fedias në "*Kufoma e gjallë*" të Tolstoit. Me siguri që do të ju interesojë.

Ndërkohë sekretarja- mbasi hodhi një shikim shfajësimi zotit Konlehner tha:

- Ja! Unë kam këtu në katalog një dokument për Shqipërinë në vitin 1936. E mori dhe na e vuri përpara.

Ndërhyrja e saj pa marrë leje eprorit në kushte normale tingëllonte si mungesë korrektese e respekti, por ajo e bënte këtë për të na ndihmuar ne mbasi zbuloi të njëjtën prirje dhe dashamirësi edhe nga shefi i saj. Kështu që ai nuk ia mori për keq por e falënderoi.

Biseda vazhdoi e përzëmërt gadi një orë.Ai shprehu gadishmërinë për të na ndihmuar dhe lamë takim për të nesërmen për të filluar punën tonë kërkimore.U larguam të kënaqur për suksesin e parë. Mikpritja dhe gadishmëria e tyre na shtoi besimin se ne do t'i arrinim synimet tona. Para se të dilnim nga dera ai na ndaloi përsëri :

-Zoti Hoxha, një minutë ju lutem. Më lindi një ide. Kam një mikun t'im në Televizionin Austriak. Ata kanë vendosur sistemin e Kompjuterit e ndoshta mund të gjeni ndonjë gjë që ka lidhje me vendin tuaj që ne nuk e kemi.-dhe shkoi e mori një copë letër në tavolinën e punës e shkroi adresën dhe numurin e telefonit të mikut të tij:

-Urdhëroni! Ju mund ti telefononi për të lënë takim- i thoni që vini nga ana e ime.

E falënderuam këtë njeri korrekt dhe të gatshëm për të na ndihmuar me çdo kusht dhe dolëm.Unë ndieja një gëzim të brendëshëm.Isha i kënaqur që po vërtetoheshin ato që u kisha thënë më parë Marianthit dhe sekretarit të ambasadës: "Do ta shifni vetë, ata janë të përzëmërt"! Përveç të tjerave unë isha i kënaqur që po zhgënjehesha nga mendimi që kisha pasur dikur se austriakët janë njerëz të ftohtë dhe tepër zyrtarë.Nuk di as vetë nga kishte lindur ky mendim. Ndoshta nga ato që kisha dëgjuar në vitet e rinisë sime kur kryeja studimet në Çekoslovaki.

Në Muzeun e filmave fillimi ishte i mbarë. Porsa shkuam në Ambasadë morëm në telefon drejtorin shkencor të Arkivit

Austriak të Filmave Dr. Walter Fritz.Në atë arkiv kishim shpresa më të mëdha mbasi edhe informacioni ynë ishte më i plotë.Lamë takim për të nesërmen mbas dite.

U çuditëm kur pas një ore nga koha që ishim ndarë nga zoti Konlehner morëm në telefon Televizionin Austriak dhe ata na thanë se ishin në dijeni dhe na prisnin. Zoti Konlehner e kishte bërë punën e tij dhe na e kishte përgatitur vizitën tonë atje.Kështu që të nesërmen do kishim një ditë tepër të ngarkuar.

* * *

Që në mëngjes shkuam për kërkime në Muzeun e Filmave Austriak (Osterreische Film Musseum).

Sekretarja na priti me përzëmërsi, na futi në një sallë dhe për pesë minuta tavolina e gjatë u mbush me dosjet që përmbanin katalogët e filmave të xhiruara 1912-1938. Përsëri merreshim vesh mjaft mirë,megjithëse interesat tona në gjuhë ishin të kundërta.Unë përpiqesha të praktikoja gjermanishten, të cilën kisha shumë vjet që nuk e kisha përdorur dhe e kisha harruar, ndërsa ajo donte të fliste anglisht, të cilën edhe unë nuk e zotëroja mirë.

Pas pak hyri në sallë zoti Konlehner.I qeshur dhe i përzëmërt na uroi mirseardhjen, porositi kafen, na pyeti nëse na mungonte gjë dhe me korektesë u nis të dilte. Te dera u kthye përsëri dhe na u drejtua:

-Nuk dua të ju pengoj në punë, por mbasi të shifni filmat që ju interesojnë do të isha i gëzuar të hanim një drekë bashkë.

E falënderuam përsëri këtë burrë simpatik.Edhe sekretarja ishte kopje e tij. S'dinte si të na shërbente më mirë.Mbasi punuam disa orë, nxorëm listën e filmave që na interesonin dhe sekretarja e fotokopjoi menjëherë duke na caktuar edhe ditën kur do i shikonim ato diku në periferi të Vienës.

Në orën dy mbas dite shkuam në takimin që kishim lënë me Dr. W.Fritz. E njihja zotin Fritz, kishim pirë dikur së bashku nga një godë konjak "Skënderbeu", unë i dhashë atij një shishe, ndërsa ai më dhuroi një libër që kish shkruar vetë për historinë e filmit Austriak.Por ky takim ishte shumë i rëndësishëm për ne, mbasi siç përmëndëm kishnim disa synime më konkrete- një listë filmash të xhiruara në Shqipëri nga austriakët dhe kineastë të tjerë europianë nga vitet 1914-1944 që unë kisha nxjerrë nga gazetat e kohës, nga dosjet e shumta të Arkivit të Shtetit si dhe nga një filmografi mbi filmin dokumentar austriak 1905-1914 shkruar nga zoti Fritz.

Porsa e lajmëroi sekretarja, zoti Fritz doli e na priti në koridor me një korektesë shkencëtari dhe një buzëqeshje të rezervuar por që kuptohesh lehtë se ishte e përzëmërt. Pamja e tij të impononte respekt për një studjonjës serioz.Mbasi mbaruam bisedën e zakonëshme të mirseardhjes ai doli vetë në temë.Përpara mbante një listë filmash nga e cila zbulova se ishte kopja e po asaj që kisha edhe unë.Ne prisnim me ankth në se i kishte filmat që kërkonim, ose do të na përgjigjesh në të njëjtën mënyrë sikurse 4 vjet më parë zonja Maria Adriana Prolo në Torino.

-Ne i kemi filmat që ju na kini kërkuar- e theu heshtjen zoti Fritz-, ndërsa për filma të tjerë ju mund të bëni kërkime më të plota.

Unë u çela në fytyrë dhe s'dija si ta falënderoja. Edhe Marianthi u gjallërua dhe shikoi nga unë gjithë gëzim. Biseda kaloi e ngrohtë. Ai u interesua për filmat dhe kinematografinë tonë.

-Do të dëshëroja të shifja ndonjë film shqiptar.

-Ne jemi gadi të ju shfaqim. Kemi me vete në video-kasetë dy filma, mund t'ja u japim

- Do të isha shumë i kënaqur.

Lamë ditën dhe orën për shikimin e filmave dhe u ndamë me përzëmërsi.Ai na shoqëroi deri jashtë.

Na priste Televizioni Austriak.Pritja qe njëllojë, megjithëse i gjithë personeli ishte në valën e punës siç ndodh kudo në studiot televizive. Ata morën kërkesat tona dhe i bënë pyetjet që u dhamë kompjuterit.Kërkuan çdo gjë që kish lidhje me vendin tonë që nga Lufta e Parë Botërore, mbi Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, Konferencën e Paqes në Paris më 1919, mbi Aleksandër Moisiun, Fan Nolin, Ismail Qemalin që kanë jetuar ose ndërmarrë udhëtime shërbimi diplomatik në Vienë në situatat më të vështira të vendit, mbi inxhinerin me origjinë shqiptare Karl Gega etj.Ndiqnim me kureshtje përgjigjet e memories elektronike në ekranin e monitorit të kompjuterit.Por asgjë e veçantë, me përjashtim të atyre fondeve që ndodheshin në arkivat e mësipërme dhe ishin hedhur në memorien e kompjuterit.Kishin edhe matëriale nga fundi i viteve 50-të e këtej por pa interes për ne.Shpresat që patëm nga Televizioni Austriak nuk u përligjën, me gjithë dëshirën e mirë dhe pritjen e ngrohtë të personelit.

Mbas këtyre takimeve e ndienim veten më të qetë, ishnim plot shpresa se nuk do dilnim pa gjë, prandaj dy ditët e pushimit- të shtunën dhe të dielën që atje nuk punohet, menduam t'i shfrytëzonim sa më mirë për njohjen e Vienës, për të vizituar monumentet e pa-mbaruara të kulturës dhe artit, mrekullitë e ndërtuara që nga fillimi i mijëvjeçarit të fundit.

* * *

Wienë!

Vienën unë diçka e njifja.Një vit më parë kisha qënë në disa muzeume si në atë të Arteve të Bukura ku na mahnitën tablotë origjinale të piktorëve të shquar hollandezë Rembrand, Van Dyke, Rubens etj. Kishim parë edhe Pallatin e Perandorëve të dinastisë së Habsburgëve nëpërmjet të cilit u njohëm jo vetëm me jetën prallore të perandorëve, mbretërve, princërve dhe princeshave, por edhe me historinë e Austrisë dhe një pjesë të historisë së evropës në të cilën ajo ka ushtruar një ndikim të madh në të kaluarën. Në muzeumin ku ruheshin sarkofagët hermetikë të derdhura në hekur e bronz, të punuar me lloj-lloj mbishkrimesh e zbukurimesh të mbretërve dhe princërve, shoqëruesja ndërhyri me humor :

- Këtu ndodhen vetëm trupat e personazheve historikë, por zemrën nuk e kanë- shikoi një herë nga ne me buzëqeshje dhe vijoi :

- Ato ruhen në një muze tjetër. Do të thoni ju pse ? Thjesht, për të marrë dy herë para nga vizitorët !

Në pallatin" *Shwarzenberg*" na shtruan një drekë.Edhe aty ish derdhur lumë djersa e puntorëve austriakë dhe të shumë vendeve të tjera evropiane, ish derdhur talenti i arkitektëve, inxhinerëve, specialistëve, piktorëve dhe skulptorëve. Pak më tej, në një park të mbuluar me lule dhe akuariume qëndron madhështor pallati " *Belvedere*" në të cilin gjithashtu janë vendosur një mori veprash arti që kur e viziton nuk të bëhet të largohesh prej tij. Ky kompleks arkiteknonik dhe urbanistik është një shëtitore e këndëshme e mbrëmjeve të freskëta vieneze.

Duke udhëtuar me makinë, pa pritur, Marianthi thirri sikur kish zbuluar diçka :

- Ja "*BurgTheatri*"- e njohu nga ato që kish parë në televizor.

Ndaluam një çast dhe e soditëm.Nuk ngopeshim duke e parë, na dukej sikur shifnim aktorin tonë të madh Aleksandër Moisiu i cili në këtë teatër kish mahnitur vizitorët me talentin e interpretimit të tij.Sa herë që kalonim andej Marianthi gjithnjë thërriste: Ja Burgtheatri, sikur bënte një zbulim të ri.

Viena është e pakonceptueshme pa Shtrausin dhe muzikën e tij.Aty përballë hotelit luksoz " *Interkontinental*" ndodhet parku i qytetit. Në hyrjen e tij është një ndërtesë historia e së cilës është e lidhur pazgjidhmërisht me Shtrausin. Çdo vizitor i huaj nuk mund të rrijë pa shkuar atje në mbrëmje.Muzika që atje interpretohet pa ndërprerje çdo ditë dhe përsëritet me vite e dekada, janë veprat e Shtrausit e sidomos valset e tij të famshme që nuk u plakën dhe nuk do të plaken nga shekujt.Aty shkojnë vizitorët nga e gjithë bota, ulen e pinë ndonjë pije freskuese, dëgjojnë pa pushim e me endje muzikën e Shtrausit të interpretuar me virtuozitet dhe dëshirë të pa shuar nga një orkestër relativisht e vogël që elektrizon sallën në dimër dhe gjithë vizitorët e parkut në verë të cilët, për mungesë vendi, rrethojnë sheshin e kërcimit dhe dëgjojnë me orë të tëra. Në një qoshe të ndërtesës kryesore qëndrojnë disa çifte balerinësh të cilët herë pas herë dalin në arenë të shoqëruar nga duartrokitjet dhe, porsa ulen ata, ngrihen çifte të shumta të moshuarish dhe të rinjsh që gjithashtu shoqërohen nga duartrokitjet e vizitorëve.Gjithë parku elektrizohet dhe kthehet në një atmosferë të hareshme.Duhet të kesh durim të fortë që të mos dalësh në arenë dhe të kërcesh bashkë me të tjerët.Unë e kisha këtë dëshirë të zjarrtë sinjë amator i vallzimit e veçanërisht i valsit,por për ne disa gjëra atëhere mund të shkaktonin probleme.

Në Vienë ka shumë vende historike, monumente, buste e përkujtimore që janë të lidhura me emrin e Shtrausit. Edhe në hotelin "*Interkontinental*" një nga sallat më të bukura të tij ku

zhvillohen takime e kongrese Ndërkombëtare quhet salla "*Johan Shtraus*".Shtrausi të ndjek kudo. Jo shumë larg operës së Vienës ndodhet pallati i koncerteve i njohur në gjithë botën nëpërmjet të koncerteve të vitit të ri, biletat e të cilit mezi sigurohen që një vit më parë. E njojtëm këtë ndërtesë nga statuja e madhe e veshur në ar që është vendosur në anën e majtë të hyrjes së saj, e cila nga lartësia, e kalon kulmin e ndërtesës kryesore.

* * *

Osterreichische filmarchiv

Të hënën na priste surpriza.Në Arkivin Austriak të Filmave (Osterreische Filmarchiv) do shikonim filmat që kishnim zgjedhur.Gjithë kureshtje u ulëm pranë tavolinës së montazhit ku zonja Gross po na vinte filmin e parë për shikim.Marianthi mbante gadi lapsin për të shkruar përmbajtjen ndërsa unë po grumbulloja gjithë dijenitë e mia të gjermanishtes për të përkthyer titujt e sekuencave, mbasi dihet që filmat ishin pa zë dhe jepesh përmbajtja me tekst gjermanisht shkruar në hyrjen e çdo sekuence.Ishte një kronikë e vitit 1914, xhiruar në Tiranë.Në fillim dilte Esat Pashë Toptani veshur gjeneral me parinë dhe vijonte me pamjet e sarajeve të Toptanasve nga njëra anë dhe tregun e varfër të qytetit nga ana tjetër- aty ku sot ndodhet varri muze dhe monumenti i partizanit, ku atëhere e deri në Luftën Nacional Çlirimtare ka qënë një xhami që u prish gjatë luftës për çlirimin e Tiranës. Sheshi ish mbushur me njerëz veshur keq ose me veshje karakteristike tiranase, me gomerët ngarkuar me dru dhe qerret e tërhequra nga buaj ose të shtrirë për të kaluar vapën në baltën që ish në mes të qytetit,rreth e qark Urës së Tabakve.Kuadro të rralla me vlera të mëdha por edhe kuadro rrënqethëse kur i krahason ato me pamjet e asaj

kohe të qyteteve evropiane.Një rrënqethje revoltuese për padrejtësitë, shtypjen e shfrytëzimin shekullor që i janë bërë popullit tonë me tradita të lashta kulturore e patriotike nga shkelësit e shumtë të huaj që nga Romakët e deri te Perandoria Austro-hungareze që po përgatitej të fuste kthetrat e saj në Shqipëri.

Porsa mbaroi kronika, Marianthi ndërhyri e gëzuar :

- Shumë mirë! Këto kuadro do t'i marr unë t'i përdor për filmin që jam duke bërë për Tiranën.

-Prit, Marianthi, mos u nxito- ndërhyra unë në rolin e pronarit! Këto kuadro janë pasuri e të gjithve! Ato do t'ju shërbejnë të gjithë studjuesvet, kineastëve dhe punonjësve të televizionit për shumë filma.Ato duhet të përdoren me masë, kriter e funksion të caktuar.

Kronika e dytë ishte Durrësi po në vitin 1914. Menjëherë më shkoi mëndja te Kristaq Dhamo që ishte duke xhiruar një film për Durrësin.Po të ishte aty, me siguri edhe ai do të thoshte sikurse Marianthi.

Në kuadër doli porti i Durrësit dhe pazari që zhvillohesh atje. Të revoltonte fakti kur një grup fëmijësh të uritur kishin rrethuar një aristokrat, i cili tallesh me ta duke u hedhur ndonjë lëmoshë dhe ata suleshin kush ta rrëmbente i pari. M'u kujtua në çast episodi i filmit "Lulëkuqet mbi mure" kur kujdestari i konviktit tallet me cinizëm me jetimët duke u hedhur nga dritarja ndonjë krodhë buke. Një kuadër rrënqethës por i xhiruar me realizëm.

Zonja Gross dukesh e preokupuar. Porsa na vuri filmin në aparat po shkonte lart e poshtë duke shikuar nëpër raftet e shumta të mbushur me libra dhe katallogje filmash.Diçka i mungonte nga filmat që kishim zgjedhur për të shikuar.Diçka gjeti dhe erdhi pranë nesh e filloi të na përkthente fërngjisht titujt e sekuencave duke mos harruar të më bënte edhe komplimenta se e kuptoja mirë gjermanishten.

Në ekran doli Aleksandër Moisiu duke interpretuar monologun e Fedias nga "*Kufoma e gjallë*" e Tolstoit. Shikuam njeri tjetrin me gëzim. Marianthi shkruante pa pushim përmbajtjen, kthenim e rikthenim filmat për t'i rishikuar që të kishnim një ide më të kjartë.

Vura re se zonja Gross merresh vetë me të gjitha, me filmat, aparatin e montimit, katallogjet, me inventarin e librave. E pyeta :

- Ç'punë bëni këtu ?

- Pak nga të gjitha, u përgjegj, dhe pas pak vijoi :

- Jam provizore. Kam mbaruar fakultetin e filologjisë për gjermanisht dhe kam mësuar edhe fërngjishten, por nuk gjeta punë gjetkë dhe kam ardhur këtu.

- Nuk ju pëlqen kjo punë ? i thashë.

- Më pëlqen jashtë mase, po ku ta kem atë fat që të më mbajnë këtu.Do isha shumë e lumtur.

- Ç'do bëni në rast se nuk ju mbajnë ?

- Do përpiqem mos gjej ndonjë punë në Francë, ndoshta për të dhënë gjermanishten- tha e pasigurtë për avenirin e saj.

E pyeta ku i punonte bashkshorti. Ajo përsëri u përgjigj e pezmatuar.

- Nuk kam burrë, jam e divorcuar.

- Si kështu ?

Më shikoi në mënyrë pyetëse e çuditëse dhe u përgjigj :

- Ky është një problem i math tek ne.Zor të gjesh familje stabël.Ka shumë ndarje, bashkime, rindarje përsëri. Është një plagë serioze.

Na u dhimbs kjo grua e re, e shkathët, e gatëshme për të na shërbyer me korektesë dhe shumë e përzëmërt me ne. Do të doja të bisedoja më gjatë me këtë grua simpatike por nuk m'u dha mundësia. Marianthi që pati rastin m'a përshkroi më mirë portretin e saj. Ishte siç e përfyturova që në shikimin e parë.

Zonja Gross vuri filmin tjetër në aparat që paraqiste mbritjen e princit gjerman Vilhelm de Vid në Durrës më 1914 së bashku me të shoqen Sofia. Esat Pasha me shokë prisnin pjellën e matrapazllëqeve të fuqive të mëdha evropiane në kurriz të Shqipërisë në një kohë kur populli dhe atdhetarët bënin të gjitha përpjekjet për bashkimin e vendit.

Princ Vidi, një stekë e gjatë që përkulej për të mos i takuar koka në tavanin e anijes së luftës me të cilën udhëtonte, shtirej sikur i njifte zakonet e vendit dhe përkulej para autoriteteve që e prisnin duke bashkuar duart që të krijonte përshtypjen e një servili. Megjithatë këto ishin kuadro të rralla e me vlerë prandaj ne u kënaqëm edhe me shtirjen e Princit.

Kur dolën në ekran pamje të Beratit të viteve 20-të Marianthi u entusiazmua:

- Kuadro të rralla, të panjohura për ne, tha e gëzuar.

Nuk ishte fjala vetëm se Marianthi ishte nga Berati, por ishin vërtet kuadro me shumë vlerë për kinematografinë, televizionin dhe historinë e vendit në përgjithësi.

Një ditë e suksesëshme për ne. Gjetëm mjaft kronika që na interesonin deri gjatë viteve të luftës së Dytë Botërore kur Regjenca-pjella e pushtuesve gjermanë- me në krye Patër Anton Arapin e të tjerë pritesh me pompozitet nga krijuesit e saj, autoritetet ushtarake gjermane, në pallatin e Mbretit që nuk e gëzoi. Një tjetër episod tregonte luftime të ushtrisë gjermane në territorin tonë (sigurisht jepeshin vetëm gjermanët) dhe mbasi hyjnë në Shqipëri priteshin me entusiazmë nga njësitë e Ballit Kombëtar. Edhe ky një dokument diskreditonjës për tradhëtarët e kombit.

* * *

Prater!

Në mbrëmje na thanë se do shkonim në " **Prater**". Nuk dinim ç'ishte, por Kujtimi, shoqëronjësi dhe bashkudhëtari ynë i palodhur, na tregoi se do shikonim diçka interesante

Që në hyrje të parkut u befasuam dhe u futëm në një botë fantastike, midis një vezullimi të pa-ndërprerë dritash shumëngjyrëshe që ndërronin vazhdimisht intensitetin.Ngjyrat e pa-kufishme, zhurmat dhe thirrjet e gëzimit dhe të frikës të njerzve që dëfrenin në morinë e lojravet nga çpikjet më të pakonceptushme të fantazisë njerëzore të trullosnin dhe të tërhiqnin si pa u kuptuar në thellësi të "Praterit", të rejat nga më të fundit të shkencës deri te imitimet e fluturimeve kozmike dhe nga ana tjetër përbindshat, kuçedrat, dragojtë fantastikë që të kallnin datën me gjigandizmin dhe lëvizjet e tyre enigmatike. Mpleksja e muzikës të tonacioneve dhe stileve të ndryshme. me thirrjet, komentet dhe interpretimet e prestigjatorëve ose të pronarëve dhe aktorëve që reklamonin lojrat e ndryshme, qeshjet e hareshme e thirrjet e gëzimit e të frikës bashkoheshin me zhurmën e motorëve dhe shinave dhe efektet e shpejtësisë të fluturimeve kozmike.Nuk mungonin aty dancinget, klubet e mbrëmjes dhe të natës, kinematë dhe teatrot e seksit. Ishte kjo një qëndër "dëfrimi" e ngritur që në fillim të shekullit dhe e pasuruar nga viti në vit duke iu përshtatur shpikjeve dhe shijeve kontemporane të krijuesve të saj, për të tërhequr klientelë, për fitime por edhe për një përpunim të rafinuar të mëndjeve.Ishte kjo një qëndër dëfrimi e lodhje, kulture e korrupsioni, optimizmi e frike, gëzimi e tmerri që mbasi i kalonte njerzit në ekstazë i shpinte ata gradualisht e pa u kuptur në krahët e veprimeve të pavullnetëshme. Sa herë që më kujtohet ai vend dëfrimi e identifikoj me një përrallë të lashtësisë me përbindshat e frikës të plotësuar me fantazinë më të guximëshme dhe të pa kontrolluar të mendjes njerëzore për të

ardhmen që ka për qëllim fitimin maksimal për pronarët dhe hutimin për vizitorët.Ishte një vend ku të pasurit mund të shpenzonin të ardhurat e tyre të mëdhaja, ndërsa shumica tjetër duke u tulatur nëpër labirintet e saj, në një botë përrallore, të hutuar të harronin për disa çaste hallet dhe brengat e jetës.

* * *

Të nesërmen shkuam në Vienën 23 ku ndodheshin depot dhe mjediset e Muzeut Austriak të Filmave dhe do të shifnim matërialet e porositura. Zoti Konlehner na priti përsëri te dera me dy bashkëpuntore të tij, na shoqëroi në një vizitë të shkurtër në mjediset komode të muzeut të ri që sa po ishte ndërtuar. Fliste me entusiazëm, me pasionin e një studiuesi serioz që e ka për zemër punën dhe që vlerëson në apogje vlerat e mëdha të filmit në historinë e gjallë të njerëzimit. Kujdesesh për ne si për miq të vjetër, gjithmonë i qeshur dhe na kërkoi falje që u shkëput për disa çaste kur i erdhën miqtë e tij të televizionit me të cilët kishte lënë takim më parë. Herë pas herë kthehesh e na pyeste në se çdo gjë shkonte në rregull dhe në se kishim vapë prandaj rregullonte edhe regulatorët e kondicionerit të ajrit në dhomën ku ne punonim.

Këtë radhë bashkëpuntorja jonë ishte një vajzë shumë e re, në fillim pak e ndrojtur si çdo i ri kur ka përpara njerëz të pa njohur dhe me flokë të bardha, por tepër korrekte dhe e pa lodhur. Morëm vesh se nënën e kishte hungareze por hungarisht nuk dinte.Bile më bëri përshtypje kur më vonë më pyeti se cilat gjuhë dija dhe unë i thashë se di edhe gjuhën Çeke ajo më ndërhyri me naivitet :

- Pse Çekia dhe Hungaria nuk janë një ?!

Megjithatë u bindëm se nuk ishte një vajzë pa kulturë, e sjellëshme dhe e gatëshme për të na ndihmuar në çdo gjë dhe zotëronte mirë gjuhët franceze dhe angleze.

Bashkëpuntorja e jonë vinte filmat në aparatin e shikimit dhe na dolën njëra pas tjetrës Viena e viteve 1908, 1920, gjëndja e Evropës dhe botës para dhe pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore si dhe pasojat e saj, grevat, demostratat dhe përleshjet e puntorëve dhe forcave të tjera përparimtare me forcat e rendit, barrikadat, lufta e armatosur dhe masakrat e regjimit në fuqi kundër puntorëve që në vitet 20-të si pasojë e ideve të Tetorit ishin ngritur për të drejta dhe barazi shoqërore, ose përleshjet e armatosura të vitit 1934 kundër hipjes në fuqi të nazizmit. Të gjitha këto dokumenta me interes për kinematografinë dhe televizionin që përfaqësonin historinë e gjallë të fillimit të shekullit.Ne entusiazmoheshim kur shikonin këto ngjarje ndonse ato nuk kishin lidhje të drejt-përdrejtë me punën tonë kërkimore, por sidoqoftë pasuronin dijenitë dhe vizionin tonë për historinë evropiane e botërore.

Mbasi pamë dhe zgjodhëm filmat që na interesonin u takuam me zotin Fritz dhe biseduam miqësisht me të. Ndërkohë ai kishte parë filmat shqiptarë që i dhamë ne dhe tha fjalë të mira për filmin dokumentar " Tetori i këngëve" që i kish bërë përshtypje të veçantë.Edhe për filmin "Apasionata" që i kishte pëlqyer tema dhe mënyra e trajtimit.Ai shprehu dëshirën për shkëmbim reciprok të programeve të filmave duke i shfaqur në arkivat tona respektive simbas një miratimi paraprak tematik. Edhe për filmat që ne zgjodhëm u morëm vesh që t'i shkëmbenim me filma vizatimorë ose artistikë të kinematografisë sonë. Bisedat që zhvilluam me të dy drejtorët ishin të ngrohta, të përzëmërta e miqësore, midis kolegësh të të njëjtit profesion.

Gatishmëria dhe përzëmërsia e çdo punonjësi si në Muzeun ashtu edhe në Arkivin Austriak të Filmave ishte mjaft prekëse. M'u kujtua që një vit më parë ishim ulur dhe po hanim drekë me një djalë të ri, punonjës të Arkivit austriak, i cili ishte sëbashku me të fejuarën e tij. Biseduam me të gjatë gjithë drekës, ai u kënaq dhe në fund na tha :

- Nuk i kisha njohur shqiptarët nga afër, biles të them të drejtën ,kisha dëgjuar edhe ndonjë gjë të errët për ju, por sot u zhgënjeva. Për pak çaste u bëra miku i juaj.

- Zotni, m'u drejtua ai pak më vonë, në rast se do të qëndroni këtu për kërkime arkivore unë do bëhem bashkëpuntori juaj. Diçka kam parë për Shqipërinë.

Shpesh herë i bëja pyetjen vetes: Është kjo një korektesë austriake ose diçka më tepër.

U binda nga ngjarjet e mëvonëshme se burimi i kësaj korektese dhe gadishmërie për të na ndihmuar nuk ishte vetëm korektesa që është në gjakun e popullit austriak, por edhe një farë simpatie dhe respekti për popullin tonë që kanë vendet gjermanike përgjithësisht si dhe për politikën jashtë blloqeve ushtarake të shtetit tonë.Kjo ishte njëkohësisht edhe një respekt për seriozitetin dhe kujdesin që tregonim ne për traditën dhe grumbullimin e çdo gjëje që ka të bëjë me historinë e vendit.


Që nga drejtuesit shkencorë të Muzeut dhe Arkivit të Filmave, punonjësit e televizionit dhe deri te punonjësit më të thjeshtë vlerësonin kujdesin tonë për këto kërkime të filmave në arkivat europiane dhe rëndësinë e madhe që u jepnim ne ruajtjes të këtyre fondeve për t'ja u transmetuar brezave të ardhëshme.

M'u kujtua kur dikur në Berlin një gazetar gjerman pyeti se si e vlerësoni ju Fan S.Nolin dhe kur mori përgjigjen ai u ngrit e tha:

- Nëpërmjet vlerësimit që i bëni ju figurës të shquar të Fan S. Nolit, të cilin unë e kam njohur personalisht, unë kuptoj se tek ju ka forca të shëndosha përparimtare.

Tiranë, qershor, 1986

Botuar me disa ndryshime në Revistën " Nëntori ", 1986, f 116-126. Nderuar me çmim të Tretë në Konkursin letraro-artistik për publicistikë.




Esat Toptani dhe Wilhelm de Wied-Durrës



Hyrja në Tiranë e W.de Wied



Ura e Tabakve-Tiranë, 1914



Porti i Durrësit-1914



Fëmijë që presin lëmosha,Durrës,1914



Porti i Durrësit-1914






Princi W.de Wied dhe princesha Sofie






Esat Pashë Toptani



Ish xhamija te monumenti "Partizani"




Selia e OKB në Vienë





Pamje të Vienës









Muzeu "Belvedere"















Eksponate të muzeut "Belvedere"



Salla e konferencave ndërkombëtare



Parlamenti Austriak

Abaz T. Hoxha

MIDIS KOLEGËVE

Mbresa dhe shënime udhëtimi nga Republika Federale Gjermane.
(3 - 25 maj 1987)



Prashna Brana- Pragë

MIDIS KOLEGËVE

(Shënime dhe mbresa udhëtimi nga R.F.Gjermane)

Isha ulur me një shokun t'im në tavolinën e një birrarie karakteristike në rrugën "Narodni Trida" të Pragës dhe po i flisja atij për Republikën Demokratike Gjermane nga sapo isha kthyer. Bisedën na e ndërpreu një grua e moshuar, e cila, gjithë mirësjellje, na kërkoi leje për t'u ulur në tavolinën tonë të gjatë, mbasi në sallë nuk kishte vende të tjera të lira. Ajo u ul, porositi diçka dhe vazhdoi të hante e pinte e qetë birrën Pilzen.

Unë në Gjermani kisha takuar shumë dashamirës, të moshave dhe profesioneve të ndryshme,dhe nga të gjitha këto kisha pësuar një zhgënjim për gjermanët dhe Gjermaninë. Mendimet e mia po ia thoshja kolegut tim i bindur se në Gjermani çdo gjë po ndryshonte, pa ia vënë re fare gruas së moshuar që, ndonse shumë korrekte dhe e sjellëshme, po ndiqte në heshtje këtë bisedë që e brente.Në çast ajo ndërpreu ngrënien, la thikën e pirunin mbi tavolinë dhe na u drejtua me mirësjellje por edhe me një farë revolte:

- Më falni, zotni. Nuk është e sjellëshme të ndërhysh në bisedën e të tjerëve, por ju e keni gabim. Gjermanët nuk ndryshojnë- tha në mënyrë të vendosur.

- Unë po vij nga Gjermania, zonjë, dhe atje pashë se koncepti militarist dhe megalloman ka ndryshuar.Për ne popujt evropianë ka rëndësi, në radhë të parë, që Gjermania të mos marrë përsëri armët. Dhe unë këtë e pashë në sytë dhe bisedat e shumë gjermanëve të thjeshtë.Jam i mendimit se udhëheqësi i juaj Klement

Godvaldi kish të drejtë kur thoshte : "Nuk është gjermani si gjermani"...

- Ju nuk i njifni mirë gjermanët, zotni,! Ne kemi barrë mbi vehte shumë mynxyra që ata na kanë lënë.

- Unë jam shqiptar, zonjë, dhe vendi ynë ka qënë i pushtuar prej tyre. Edhe tek ne ata kanë bërë shumë krime. Lanë mbrapa një Borovë që, sikurse Lidicja juaj dhe Oraduri francez, u shua komplet që nga fëmijët e gratë e deri te pleqtë.Megjithatë ishin kohë të tjera, ishte ideologjia naziste.....

- Më dukeni tepër i ri, zotni, që t'i njifni ata-ngulmoi ajo në të sajën - duke kujtuar ndoshta shumë plagë që i kishte lënë pushtimi nazist në zemër.

Kjo bisedë e bërë në vjeshtën e vitit 1958, m'u kujtua kur po shkoja drejt konsullatës gjermane në Budapest majin e shkuar, për të marrë vizën për në Gjermaninë Perëndimore, ndërkohë që shoku im i udhëtimit, Beni, po bisedonte me punonjësin e ambasadës sonë që na shoqëronte. Roja te dera e Konsullatës dhe njerzit e shumtë të moshave dhe racave të ndryshme në pritje ose duke plotësuar formularët më krijuan një përshtypje zhgënjyese.Ndërsa shokët e mi po përpiqeshin të takonin nëpunësin që merresh me vizat unë u ula në një karrige dhe kisha vënë përballë dy mendime kontradiktore- Gjermaninë e traditave shekullore, popullin e kulturuar e korrekt, vendin e zhvilluar dhe Gjermaninë e përshtypjeve të Luftës së Dytë Botërore ose të disa ngjarjeve militariste e revanshiste të mbas luftës që i kisha jetuar. Megjithëse nuk isha më ai i gadi 30 vjetëve më parë kur po bisedoja me gruan e moshuar në birrarinë e Pragës, mosha, përvoja e jetës, ngjarjet dhe bindjet e mia ishin më solide, përsëri isha në ankthin e asaj që do më priste përpara. Më brente mendimi a do të kisha mundësinë të komunikoja lirshëm, pa zyrtarizma, shfaqje superioriteti dhe me frymë dashamirëse për të kryer detyrën që i kisha vënë vehtes në këtë udhëtim. Edhe veprimi i propagandës dhe ideologjisë sunduese

kishte lënë gjurmë në ndërgjegjen time prandaj kisha edhe mendime ogurzeza për këtë vizitë.

Njerzit venin e vinin përpara sportelit të dhomës së pritjes ndërsa disa nëpunës po kundronin me vemëndje formularët që u kishin dhënë vizitorët.Një bionde e shkathët e konsullatës, sa ngriti kokën, thirri me dashamirësi e buzëqeshje :

- Aaaa, zotrinjtë nga Ambasada Shqiptare! Si jeni, zotrinj, përse jeni munduar ?

Punonjësi i Ambasadës mbasi i ktheu përshëndetjen, i dorëzoi notën e dokumentet përkatëse. Ajo i shikoi ato me vëmëndje duke u menduar njëkohësisht për përgjigjen dhe me sytë në letër tha:

- Besoj se do të jeni të kënaqur të vini pas dy ditëve- dhe hodhi një shikim nga njerzit e shumtë që kishin mbushur dy salla dhe prisnin për vizë sikurse edhe ne. Si rregull e kemi vështirë t'i bëjmë para 4-5 ditëve.

Punonjësi i ambasadës i shpjegoi ngutjen tonë. Ajo e ndoqi me vëmëndje e buzën në gaz, që shprehte gadishmëri, duke i dhënë fund bisedës :

- Mirë zotni, do merrem personalisht me çështjen tuaj. Urdhëroni sot në orën tre.

Njerzit e shumtë që prisnin radhën e detyruan të merrej me ta, por në punë e sipër na u drejtua :

- Mirupafshim, zotrinj, do të kisha dëshirë të madhe të vizitoja edhe një herë vendin tuaj të bukur- e buzëqeshja e saj shkriu në dokumentet që porsa mori.(Ajo kishte qënë në një vizitë shërbimi në Shqipëri dhe kishte mbresa për vendin tonë).

E falënderuam për mirsjelljen dhe gadishmërinë për të na ndihmuar dhe u larguam.

Në udhëtim unë përsëri po bluaja mendimet e para. Duke kaluar nëpër njërën nga urat mbi lumin Danub, hodha shikimin bregut mahnitës të lumit në anën e ndërtesës së parlamentit

hungarez dhe të dy këto ngjarje më mbushën me shpresa për një udhëtim të mbarë e punë të frutëshme kërkimore në arkivat gjermane të filmit.

Frankfurt mbi Main

Takim me zotin Eberhard Spies

Në mbrëmje u nisëm me avion për në Frankfurt mbi Main ku zinte fill puna jonë kërkimore në disa arkiva filmike gjermane.Kontakti i parë dhe pritja miqësore e punonjëses së Konsullatës në Budapest na jepte shpresa për një fillim të mbarë, megjithatë ankthi i fillimit të punës nuk më linte të qetë, prandaj atë natë pothuajse nuk fjeta.

Të nesërmen në orën 9.30 kërkuam takim me drejtuesit e Institutit gjermanoperëndimor të Artit Filmik. Pas një minute sekretarja, me shumë mirësjellje na njoftoi se pas një ore na priste zëvëndësdrejtori i këtij Instituti Eberhard Spies (Shpis).Zotin Spies e njihja vetëm nëpërmjet të një letre që na kishte dërguar rreth dy muaj më parë me anën e së cilës, me shumë mirësjellje na kërkonte libra,katallogje mbi kinematografinë shqiptare, gjë që u bë shkas për marrdhënie miqësore midis dy institucioneve tona.

Mora edhe një herë bllokun tim të shënimeve e formulova kërkesat tona, dhe mbasi ky Institut ishte fare pranë hotelit ku ne kishim zënë vend, u nisëm me Benin në këmbë bregut të lumit Main. Dy minuta mbas komunikimit nëpërmjet të citofonit në portën e hyrjes, dera u hap dhe një topolake flokëverdhë na u prezantua duke na uruar mirseardhjen e na udhëhoqi në një ashensor për në katin e tretë të ndërtesës ku ishte kabineti i zotit Spies. Në ashensor

ajo po na shikonte me vëmëndje dhe nuk nguroi të na thoshte se shifte për herë të parë shqiptarë.

Kur dolëm nga ashensori na tërhoqi vëmëndjen një sinjal i pandërprerë monoton që binte pa pushim në të gjitha dhomat rreth e përqark koridorit. Sekretarja që pa se po na bënte përshtypje na tha të mos shqetësoheshim se ishte sinjali që njoftonte për hyrjen e personave në atë kat të Institutit. Ne kthyem kokën mbrapa dhe vumë re një mikrokamera televizive që ishte vendosur mbi daljen e ashensorit dhe ndiqte gjithë personat që dilnin prej andej. Ky sinjal, për një njeri që nuk e njeh punën arkivore e në veçanti që nuk di vlerën e dokumentacionit do të krijonte një përshtypje të zymtë survejimi, ndërsa për ne që punojmë në këto institucione na krijoi një ndjenjë respekti për ata që ruajnë këto dokumenta me vlerë të jashtëzakonëshme me përmasa botërore, jo vetëm për historinë e kinemasë, por për historinë e vetë popujve.

Zoti Spies, një meso burrë nga shtati, na priti te dera buzagaz e na udhëhoqi për në kabinetin e tij. Mbasi shkëmbyem bisedat e para të zakonëshme unë mezi prisja të hynim në temë. Mundësinë ma dha pauza nga hyrja e sekretares që mori porosinë për të na servirur diçka për të pirë.Komunikimi i përzëmërt e miqësor në baza barazie të plotë na krijoi kushte shumë premtuese.

- Ne jemi të interesuar për çdo gjë të filmuar në Shqipëri ose që ka lidhje me vendin tonë- i thashë unë, dhe desha të futesha në kërkesa më konkrete për figura të shquara, ngjarje historike etj- por ai me një ndërhyrje të shkathët më ndërpreu :

- Do të ju jap një sihariq ,zoti Hoxha. Sapo kam marrë një dokumentacion të plotë filmografik mbi aktorin e madh me origjinë shqiptare Aleksandër Moisi. Besoj se do të ishte me vlerë që të iu bëj një kopje ?

- Do të na bënit një nder të madh- ndërhyra unë i befasuar nga ky sukses i rëndësishëm i shërbimit tonë.Më gëzoi edhe fakti që ndërsa disa studiues sharlatanë të historisë së artit e mohojnë

kombësinë shqiptare të Aleksandër Moisiut, dhe ai që në fillim e pranoi këtë.

Ai shtypi përsëri butonin e ziles dhe porositi sekretaren që të fotokopjohej sa më shpejt dokumenti.Ishte kënaqësi e veçantë kur ne pamë se në atë filmografi jepeshin 18 filma të interpretuara nga Moisiu kur ne njinim vetëm 12 dhe disponojmë në arkivin tonë vetëm një.

Vumë re se ishte tepër i zënë me punë, vazhdimisht e merrnin në telefon dhe ai u jepte zgjidhje kërkesave të nëpunsvet të Institutit duke mos harruar që t'u jepte edhe sihariqin se kishin ardhur kolegët Shqiptarë dhe të përgatiste vizitën tonë në sektorët e ndryshëm të tij. Veç kësaj ne e gjetëm atë në punë e sipër studimore e ai ishte një studiues i pasionuar për çdo dokument të ri, çdo libër ose filmografi që gjente dhe kish lidhje me kinematografinë gjermane, e quante si një ngjarje të veçantë. Na foli me shumë pasion për një libër që kishte siguruar kohët e fundit-botim i vitit 1926- që ishte një kopje e rrallë dhe e gjeti e na e tregoi origjinalin dhe fotokopjen e tij. Na rekomandonte pa ndërprerje leteratyrë të ndryshme nga ku kuptuam se ishte një njohës i thellë i historisë së kinemasë prej të cilit kishte se ç'të mësoje.

Për të thyer monotoninë ndërhynte herë pas herë me një humor të shkathët dhe përpiqej të na e bënte vizitën tonë sa më të këndëshme. Mbasi u sigurua që çdo gjë ishte gati për vizitën tonë në Institut, na ftoi të hanim një drekë bashkë në njërin nga restaurantet karakteristikë të Frankfurtit.Pas dreke na udhëhoqi vetë për të vizituar Muzeun e kinemasë, në bibliotekën shkencore, në fotokopjimin e dokumentave, në sektorin e fotografive të filmave që ishin sistemuar në mënyrë të përsosur për një shfrytëzim të shpejtë. E njihte nëpër gishta çdo proces pune, ulej e spjegonte konkretisht funksionimin e pajisjeve, fotokopjoi vetë disa shkrime të kohës për Aleksandër Moisiun, mendime për interpretimet e tij

ose shkrime me rastin e 100 vjetorit të lindjes dhe na i dha aty për aty. Herë pas herë e ndërprisnin studjues të ndryshëm të historisë së kinemasë dhe ai na kërkonte falje dhe u jepte sqarime të plota për kërkesat e tyre, urdhëronte sekretaren për t'na vënë shpejt në dispozicion matërialet që kërkonim dhe përsëri na ftonte ne nga sektori në sektor e na shpjegonte pa u lodhur. Ne kishim se ç'të mësonim nga ky njeri i ditur e vullnetmadh. Para se të largoheshim ai u muar vetë me parapërgatitjen e vizitës sonë në Arkivin Federal gjermanoperëndimor në Koblenz duke precizuar orën e takimit, emrat e personave dhe na tha:

- Jam shumë i gëzuar që u njoha me ju. Nuk di nëse ju ndihmova diçka, por dëshira ime do të ishte të bëja shumë më tepër për ju. Por s'kemi kohë, sidoqoftë ne do të takohemi në Berlinin Perëndimor në Kongresin e Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmave, ku ju do të merrni pjesë. Në kohën e lirë do shihemi, do pimë ndonjë godë bashkë dhe do të ju bie atje edhe disa fotografi nga interpretimet e A. Moisiut, të cilat i kam porositur për ju.

Nuk kishte se si të mos ushqeje respekt për këtë njeri të gjerë e dashamirës dhe para se të largoheshim u ulëm e pimë bashkë nga një godë konjak "Skënderbeu", të cilin ai e vlerësoi shumë.

Zoti Spies ishte përfaqësues i atij brezi, sikurse edhe shkrimtari i madh Hajnrih Bël, që në moshën më të njomë u përdorën si mish për top nga Hitleri, por që nxorën si përfundim kryesor prej saj miqësinë midis popujve. Ai kishte qënë ushtar në Itali,zotëronte shumë mirë italishten dhe e simpatizonte popullin italian e gjithë popujt punëdashës e paqedashës. Në figurën e tij s'kish vend asnjë shovinizëm dhe nacionalizëm gjë që na gëzoi shumë, sidomos kur pamë se me të gjithë gjermanët e thjeshtë që takuam, kudo që shkuam, në Koblenz, Hanover, Berlin ose Hamburg, kishin të njëjtat ndjenja miqësie, pa fodullëkun e

nacionalizmit hitlerian dhe pa pretendime të tilla si "Deutschland uber alles" në kuptimin si e përdori këtë termë Hitleri për t'i shërbyer ideologjisë së tij naziste. Popujt e kuptojnë dhe e respektojnë shumë mirë njëri tjetrin.

* * *

Bundesarchiv Koblenz

Qyteti perlë i Koblenzit, i vendosur në kryqëzimin midis lumit Rhin dhe Mosel, na tërhoqi shumë me veçantitë e tij.Para nesh ish e shtuna dhe e diela ku atje nuk punohet prandaj kishim mundësi të kundronim shumë gjëra karakteristike nga afër.Një qytet i qetë, shëmbëllor në pastërti, ku zotëronte kryesisht stili klasik i ndërtimeve, por që monotonia e klasiçizmit thyhej nga ndonjë ndërtesë tregtare moderne prej xhami dhe alumini.U njohëm që më parë edhe me ndërtesën madhështore të Bundesarchivit (Arkivit Federal) për ta patur më të lehtë vizitën atje.

Të hënën në orën 9.00 u paraqitëm në Bundesarchiv.Na priti zoti Regel,shef i departamentit të Filmit Artistik të cilin e njoha menjëherë nga fotografia që më kishte dërguar ca kohë më parë, nga që donte të vinte tek ne për të njëjtën arsye që shkuam edhe ne atje. Na përshëndeti përzëmërsisht dhe na udhëhoqi nëpër labirintet e Arkivit për në kabinetin e tij ku thirri edhe një përfaqësues të filmit dokumentar e kronikal për të cilët ne kishim interes posaçërisht. Sipas kërkesave që i kishim bërë me shkrim dhe njoftimeve nëpërmjet zotit Spies, ai kish bërë një punë paraprake, por kur u njoh më afër me kërkesat tona na vuri në dispozicion disa katallogje për të bërë një punë më të thellë kërkimore e ndërkohë dha porosinë që të bëheshin gati filmat e

parë deri sa ne të vizitonim Bundesarchivin.Në këtë vizitë në Bundesarchiv që kishte pak kohë që ishte ndërtuar, na bëri përshtypje çdo gjë, që nga pastërtia shëmbëllore, teknologjia bashkëkohore, funksionaliteti i çdo sektori, siguria teknike dhe nga rreziqet e zjarrit, mbrojtja e plotë e ndërtesës dhe e fondit me aparate të sofistikuara nga çdo keqbërës e deri te gjithë personeli serioz, i pasionuar, korrekt e dashamirës.Këtë të fundit e ndiem në çdo hallkë që shkuam që tek vajzat dhe djemtë e rinj që bënin nga punët më të thjeshta e deri te kuadrot më kryesore.E pamë sidomos tek kolegët Regel,Witzenrad, inxhineri Luck me të cilët bashkëpunuam gjithë javën.

Të nesërmen mezi prisnim të shifnim filmat. Witzenrad vuri filmin e parë në maviolë. Në ekranin e vogël të saj doli titulli " *Das schwarze Los* " (Fati i zi). E kisha titullin e këtij filmi në filmografinë që më- kishte dhënë zoti Spies, por nuk e mendoja kurrë që filmin do ta gjeja e sidomos aqë të plotë e të saktë, teknikisht në gjendje të shkëlqyer.Ndiqja gjithë emocion interpretimin e aktorit të madh në filmin e tij të parë së bashku me atë që më vonë do të bëhesh bashkëshortja e tij- Johana Terwin (Moisi). Mbresat e mija i gjeta të konkretizuara në një kronikë franceze që pashë pas tij ku i bëhej jehonë këtij interpretimi- me filmreklamën që ngrinte lart figurën e Moisiut ku ndër të tjera thuhesh :

- Shoqëria Bioscop-Film po xhiron filmin "*Das schwarze Los*" ku interpreton aktori më në zë i kohës sonë A.Moisi....Disa kuadro të filmit që tregojnë talentin e madh të mimikës së tij....."

Ndonse për kronikën franceze unë isha në dijeni që më parë i quajta të dyja këto si një zbulim të ri.

Witzenrad më shikonte nga pas vazhdimisht me buzëqeshje nga që isha dhënë plotësisht pas shikimit dhe as që më shkonte ndër mend të pija ndonjë kafe. Aty nga ora 13.00 u kujtova se kolegu im duhej të kishte shkuar për drekë dhe i kërkova ndjesë

që e vonova. Ai nguli këmbë të shkonim bashkë. E quaja çdo minutë të humbur si një krim karshi detyrës dhe pasionit, prandaj edhe unë ngula këmbë që ai të shkonte vetëm. Aqë po më tërhiqnin kronikat që po shifja njëra pas tjetrës saqë nuk e kuptova fare se ora kish shkuar 17.00 kur ata linin punën. U kërkova ndjesë për këtë dhe u ngrita e shkuam së bashku. Kjo punë vazhdoi edhe të nesërmen e të pasnesërmen, deri të premten. Transporteri binte filma pa ndërprerje dhe kolegu im i përgatiste për shikim. Ditën e tretë aty nga ora 12.30 dëgjova pas meje një zë :

- Mos mbani gjë Ramazan, zoti Hoxha. ? Keni kaq ditë që nuk ngriheni nga tavolina prej orës 9-17 pa ngrënë..."

Ishte zoti Regel, i cili kish hyrë prej kohësh në dhomë, por që unë nuk e kisha vënë re ngaqë isha dhënë shumë mbas disa kronikave nga Lufta Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore. Ngjarjet zhvilloheshin në Manastir, Ohër, Strugë, Shkup, Nish, Leskovec etj...."

Ktheva kokën e buzëqesha. U shfajësova duke i thënë:

- Keni të drejtë, zoti Regel, por unë të shtunën do largohem për në Berlin, prandaj çdo minutë më duket një shekull i humbur...

- Megjithatë-tha ai- stomaku duhet të jetë plot që të kesh energji për të punuar...Jashtë na pret makina që të shkojmë të hamë një drekë të thjeshtë bashkë...

E falënderova dhe u detyrova të ngrihem.Shkuam e morëm Benin që i shoqëruar nga inxhineri Luck, po njihej me teknologjinë e mirëmbajtjes dhe kontrollit të filmave si dhe me pajisjet e tjera teknike të Bundesarchivit.

Dita tjetër një kënaqësi e re.Në ekran dolën kuadrot e filmit dokumentar "*Tregjet e Shqipërisë*", xhiruar në vitin 1932. Ishte i pari film me zë i xhiruar në Shqipëri, prandaj, përveç vlerave dokumentare dhe paraqitjes së atmosferës së kohës, përbënte edhe një dokument historik për filmin në Shqipëri.Edhe filmat " *Një*

udhëtim nëpër Shqipëri" (1935) dhe " *Një udhëtim ëndërronjës nëpër Shqipëri*"(1936) ishin një pasuri e rrallë për arkivin tonë të filmit, dokumente me rëndësi të madhe për kinematografinë dhe televizionin. Filmi i parë shoqërohej me motive të muzikës popullore shqiptare sipas krahinave ku zhvilloheshin ngjarjet.Këta të dy filma plotësonin dhe pasuronin gamën e dokumentacionit filmik për krahina të ndryshme të Shqipërisë në atë kohë dhe jo vetëm për Tiranën e Shkodrën, për të cilat disponojmë më shumë dokumenta, por edhe për Krujën e Kukësin, Elbasanin e Dibrën, Korçën e Kavajën, Malësinë e madhe e luginën e Drinit e të Osumit. Në këto kuadro me vlerë dilnin jo vetëm qytetarë e fshatarë, priftërinj e xhandarë, por edhe disa rite e këngë e valle popullore nga krahina të ndryshme, tregje dhe punime artizanati, fshatarë që hapnin rrugë, kufitarë, kufijtë shtetërorë, gra e fëmijë gjithë zhele që të kujtonin " Lulin e vocërr" të Migjenit, punime lëkurësh e ndërtim mullinjsh, jetën baritore etj.

Mbaroi edhe një ditë e mbushur me emocione, filloi një natë e trazuar gjithë ëndërra ku mplekseshin e kaluara dhe e sotmja, ku viheshin përballë njëra tjetrës gëzimi për zbulimin e këtyre dokumentave, por edhe revolta për prapambetjen e madhe të vendit tonë në atë kohë, dashuria për popullin e thjeshtë, trim, patriot e punëdashës dhe urrejtja për ata që e kishin lënë në mbrapambetje e mjerim të plotë.

* * *

Ditën tjetër vërshuan në ekranin e vogël Perandorët, Knjazët, Carët, Mbretërit, Princërit, Gjeneralët e Feldmarshallët e Evropës në prag dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, kur bisedohej për fatet e njerëzimit, bëheshin aleanca e marrëveshje të fshehta në kurriz të popujve evropianë e veçanërisht të Shqipërisë.Ishin ngjarjet që zhvilloheshin në kohën e gjendjes së vështirë, të periudhës

fatale, kur luhesh nga fuqitë e mëdha dhe shovinistët fqinjë në kurriz të Shqipërisë, që hidhnin dritë mbi vështirësitë kolosale që u janë dashur të kapërxejnë patriotët dhe populli shqiptar.Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor ishin kthyer në një fushë beteje të përgjakëshme. Këto kronika të rrënqethnin dhe të mbushnin me urrejtje për autorët e këtyre kasapanave, Franz Jozefët e Ferdinandët, Wilhelmët e Sulltan Reshatët, Borisët e Karlët, Mahmut Shefqet Pashët e Fon Markenzetë etj, etj.

Viti 1918. Tetori i ngjarjeve të mëdha që dha shkëndijat e shpërthimeve revolucionare në Evropë, nëpër rrugët e Berlinit ngrihen barrikada, marshon populli i armatosur, i prirë nga flamuri drapër e çekan. Në Munich shpërthen revolucioni Bavarez, përleshje me armë. Para mbledhjes së Parlamentit populli demonstron me në krye udhëheqsit e tyre revolucionarë Karel Libnecht, udhëheqës të grupit "Spartak". Në ekran dalin personalitete të majta, populli dhe Ushtria e kuqe e revolucionit, klasa puntore është hedhur në beteja, periudhë historike e proletariatit gjerman. Kronika të tjera pasqyronin veprimtarinë revolucionare të K. Libnechtit, Ernest Thalmanit, figurave politike të kohës si E. Bernshtain, K. Kaucky, Molekbuhr, figura të shquara të kulturës dhe personalitete të tjera politike si Tomas Man, Bernard Shou, Anderson Nexo, Tomas Edison, Herman Suderman, August Bebel, Mustafa Qemal Ataturk, M. Gandi etj, etj.

Refleks i ngjarjeve revolucionare, i gjendjes së mjeruar të klasës punëtore dhe popullit gjerman ndikon drejtpërsëdrejti në artin e shtatë. Lindën shkëndijat e para të kinematografisë përparimtare që pasqyrohet në vepra të tilla si " *Rrugica pa gëzime*" (1925) e regjisorit të njohur Georg Wilhelm Pabst, ku shkëlqeu figura e aktores së madhe suedeze Greta Garbo dhe e shumë të njohurës në atë kohë, danezes Asta Nielsen.Werner Hochbau xhiron filmin " *Bruder*" (Vëllezërit) në të cilin jepet jeta e rëndë e klasës puntore, domosdoshmëria e ngritjes në protestë

dhe e bashkimit për t'i përballuar borgjezisë dhe reaksionit.Në ekran del filmi " *Problemet e kohës-ç'farë kërkojnë puntorët* ? "(1930) e regjisorit të njohur përparimtar Slatan Dudov, autorit të shumë veprave militante të mëvonëshme si " *Jeta e punëtorit Berlinez*" ose e kryeveprës së tij në atë kohë " *Kuhle Wampe oder wem gehort die welt*? (Barqet e akullta ose kujt i përket bota, 1930) shëmbëll klasik i realizmit Socialist në kinema..Filmi "*Problemet e kohës*" jepte një pasqyrë të gjendjes së rëndë të punëtorëvet, kushtet e këqija të jetesës e dhënë kjo në kontrast me atë të borgjezisë dhe të shtresave të larta, një pamflet politik që bënte thirrje për t'u ngritur në luftë për të drejta shoqërore.

Njerëzimit po i kanosesh një rrezik i ri, fashizmi kërcënonte botën, forcat përparimtare kundërveprojnë. Viti 1929, në Frankfurt zhvillon punimet Kongresi Antiimperialist, në të marrin pjesë personalitete të shquara dhe antifashiste e, midis tyre edhe Noli ynë..Manifestime të gjera në Berlin më 1 gusht 1929 me parullën " Luftë, luftës imperialiste".

Në ekran parakalon historia e gjallë, të duket sikur i jeton, merr pjesë në këto ngjarje. Filmi ka një forcë ndikuese magjepëse. Ngjarje të reja, figura të reja, katastrofa e re botërore. Fashizmi e nazizmi shpërthejnë luftën më të përgjakshme. Hitleri e Musolini çirren e kërcënojnë me pozat e të çakërdisurve.Hitleri viziton Pragën e pushtuar nga trupat gjermane e pritet si perëndi gjatë kthimit në Berlin. Ngjarjet e përgjakëshme të Spanjës, "Pakti Antikomintern", lufta botërore. Në Tiranë krijohet "Regjenca", pjellë e pushtuesve nazistë, në malet e Shqipërisë zhvillohen luftime të ashpra (marrë nga ana gjermane), "Konferenca e Sanfranciskos", " Konferenca e Teheranit", e "Potsdamit", nënshkrimi i akteve të kapitullimit, fundi i llogjikshëm i makinës ushtarake naziste.Ditët e para në Berlinin që po merrte frymë lirisht, i shkatërruar, i varfëruar, i sakatuar, por i çliruar dhe i operuar nga plaga kanceroze naziste.

Puna e jonë kërkimore në Koblenz përfundon.Përshëndetemi me kolegët tanë që na krijuan kushte të përshtatëshme që na dhanë mundësinë të shikojmë në ekran një paradë të ngjarjeve më të rëndësishme të shekullit..I falënderojmë ata për ndihmën miqësore.

Mirupafshim në Berlin !

* * *

Drejt Berlinit Perëndimor

Plot mbresa dhe të dehur nga kënaqësia që të jep puna kërkimore, nisemi drejt Berlinit Perëndimor. Është një udhëtim i këndëshëm nëpër luginën e lumit Rhin, drejt veriut. Preferuam të udhëtojmë me tren.Rruga çan midis kodrave në majat e të cilavet vigjëlojnë kullat dhe kalatë mesjetare të kthyera në muze. Aq të shumta janë këto kulla dhe ndërtesa karakteristike sa që të duket sikur çan nëpërmjet mesjetës.Të bien në sy në krahun e djathtë dy kështjella të vendosura në kodrat karshi njëra-tjetrës.Në hartë shënohet " Qyteti mace" dhe " Qyteti mi". Na shpjegojnë se këto qytete mesjetare kanë shkuar si "macja me miun" në shekuj. Rruga është e bukur, nëpër lumë lundrojnë anijet turistike ose të mallrave, në dy anët e tij rrugët e gjera automobilistike, nervat, arteriet dhe venat e çdo shteti.

Bon...Këln...Dysseldorf..Essen,..Dorthmund... Hanover dhe pastaj "*lugina e mendimeve*" korridori që çan nëpërmjet territorit të Republikës Demokratike Gjermane drejt Berlinit. Në fakt ajo nuk është një luginë, ajo çan nëpërmjet lëndinave, por të krijon përshtypjen sikur udhëton midis maleve, i izoluar nga bota. Një mbresë e jashtëzakonshme ! Përse vallë ?..... Treni ecën ngadalë. Befas shikojmë shumë tanke që çajnë midis fushave, rrugë të reja që nuk kanë ekzistuar më parë kryqëzohen në pyjet,

arat, lëndinat. Toka është kthyer në ugar. Morëm vesh se zhvillohen manovrat e trupave të Traktatit të Warshavës.

Potsdam !

Duke kaluar nëpër Potsdam më rishfaqen në ekran ngjarjet e zhvilluara aty.Konferenca e Potsdamit.Churchill, Stalin, Rusvelti duke nënëshkruar marrëveshjen .Por këtu kam edhe kujtime të mijat, të rinisë sime.Shumë vjet më parë kam qënë këtu me shokun tim të ngushtë, kinooperatorin e talentuar Petraq Lubonja. Më kujtohet ai, i thjeshtë, i matur, i thellë në mendime që këndonte aqë bukur kanconetat italiane.U nda prej nesh në kulmin e punës krijuese.

Sa më shumë i afrohesh Berlinit aqë më shumë përzihen mendimet.E ndien veten të shqetësuar, ndoshta aqë të shqetësuar, sa edhe vetë qyteti 750 vjeçar që po feston ditlindjen.

Berlin !

Qytet i trazuar, qytet i pagjumë. Përse vallë ? Ndoshta vigjëlon për fatet e tij.Dikush e quajti " qytet i çmëndur"! Ndoshta nga që jeta s' pushon as ditë as natë që, përveç berlinezëvet, të premteve e të shtunave vërshojnë pa ndërprerje drejt tij lumi i dhjetramijrave nga e gjithë Gjermania dhe Evropa.Qyteti i kabareve, diskotekave dhe klubeve që s'flenë asnjëherë, që punojnë ditë e natë, 24 orë, qyteti që nuk e njef termin " Night Club", i 25.000 policëve ku nuk vepron asnjë rregull policie, i kontrasteve të thella ekonomike e shoqërore. i emigrantëve të panumërt. Berlini i dëfrimit dhe i çmëndurisë, i kulturës dhe i njerzve të shthurur, i teatrove dhe i kinemave të panumërta që punojnë pa ndërprerje. Të bën përshtypje- këtu kinematë frekuentohen më tepër se në çdo vend tjetër të Gjermanisë dhe ndoshta edhe të Evropës.Ndoshta

kjo ka mbetur si një traditë.Djepi i teatrit Gjerman që i ka dhënë Gjermanisë, Evropës dhe botës figura të shquara të teatrit dhe kinematografisë.Berlini i Maks Rheinhardt-it dhe Bertold Brecht-it, i Albert Basserman-it dhe Fritz Kortner-it, Konrad Veidt-it. Berlini i Moisiut tonë, gjurmët e të cilit duken kudo në teatrot ose kinematë ku janë dhënë premierat e filmave të interpretuara prej tij që në fillim të shekullit. Qyteti ku filluan veprimtarinë e tyre regjisorë dhe aktorë të njohur të teatrit dhe kinematografisë G.W.Pabst, F.W.Murnau, Henny Porten dhe Emil Jannings, Fritz Lang dhe Ernest Lubitch, W. Hochbau dhe S.Dudov, Marlen Dietrich dhe Brigit Helm, ku dha provat e para shpresëdhënëse Greta Garbo ("Rrugica pa gëzime"). Berlini i ngjarjeve të bujëshme e trishtuese, ku mblidheshin Perandorët e Mbretërit e tregtonin fatet e popujve të vegjël. Berlini i Kongresit të 1878-ës ku u morën nëpër këmbë fatet e Shqipërisë, ku Bismarku e quante atë " një shprehje gjeografike".Berlini i histerisë së luftës, i kërcënimeve, presioneve dhe shantazheve, i paradave dhe fjalimeve grykëçjerra të Hitlerit. Berlini i traditave revolucionare dhe i përleshjeve klasore, i Karl Libnecht-it, Roza Luxemburgu-t dhe Ernest Thalmani-t me shokë. Berlini i terrorit hitlerian.....

Ja Reichstagu, ish ndërtesa e Parlamentit gjerman vullneti i të cilit diktohesh nga Hitleri, që sot është kthyer në muze. Të kujton ai terrorin nazist kundër lëvizjes antiimperialiste, të kujton Gjergj Dimitrovin dhe "Procesin e Leipsigu-t".Më tej portat e famëshme të "Brandeburgut" që nuk janë më porta, por që janë kthyer në kala të pakalushme. Në rrjesht me to është gjithashtu "Muri- kala", muri famëkeq i Berlinit, një plagë e madhe për Berlinezët dhe gjithë Gjermaninë, një plagë që u bën thirrje ndërgjegjes së tyre. Qyteti i anktheve të familjeve të ndara nga muri i pakapërxyeshëm.

Berlini i Festivaleve, panaireve dhe Kongreseve Ndërkombëtare.

17 Maj 1987.Jemi në "Qëndrën e Kongreseve Ndërkombëtare".Takohemi me shumë kolegë e miq.Eberhard Spies na afrohet dhe na përshëndet me gjallëri.Premtimin nuk e ka harruar, hap çantën dhe nxierr andej disa fotografi me cilësi të shkëlqyer nga interpretimet e Aleksandër Moisiut.E falënderojmë.Ai na kërkon falje se duhet të largohet.Pas pak fillon Kongresi i Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmave, për të cilin kemi ardhur edhe ne. Ai është një nga organizatorët, prandaj ka shumë punë për të kryer.

- *Do takohemi përsëri*- thotë ai në ikje e sipër- *dua t'ju gostis në Berlinin tim*-. Ai është me origjinë nga Berlini.

Fillon Kongresi, simpoziumi teknik, diskutimet e gjera për probleme të arkivave të filmave, vizionimi i filmave klasikë e të restauruar, panairi i pajisjeve të mirëmbajtjes, kontrollit dhe restaurimit të filmave etj. Shtatë ditë jashtëzakonisht të ngarkuara. Nuk ke kohë të marrësh frymë.

Në pushimet midis seancave takojmë miqtë tanë Regel dhe Witzenrad.Në njërin nga pushimet zoti Regel na prezanton një burrë simpatik e të qeshur.Në flokët e tij të zeza ka kohë që lundrojnë shumë thinja. Është shefi i tij, përgjegjës i Arkivit Filmik në Koblenz. Ai na kërkon ndjesë që nuk pati mundësi të na takonte në Koblenz mbasi ishte me leje të zakonëshme. Interesohet për ne, në se kemi ndonjë nevojë, në se kemi kryer punë dhe çfarë dëshirash të tjera kemi.Një njeri dashamirës si gjithë të tjerët.I thamë se vartësit e tij na kishin dhënë gjithë ndihmën dhe se kishte bashkëpuntorë të pasionuar, studjues seriozë e të palodhur. Komplimentit iu përgjigj me kompliment.

- Studiuesit seriozë mund të dallohen vetëm nga sytë e studiuesve seriozë e të pasionuar- tha ai dhe priti sa u bind se e kuptuam komplimentin.

E falënderuam për vlerësimin.

Na afrohet zonja Eva Orbanz e Kinematekës gjermane në Berlin, një grua e qeshur, por që çuditërisht në çast merr pamje aqë serioze sa që të krijon përshtypjen se është nurzezë. Por jo, ajo është e përzëmërt dhe puntore e palodhur.Në shpatullat e saj ka rënduar kryesisht organizimi i gjithë veprimtarive në Berlin. Kongresi, simpoziumi etj. Na përshëndet dhe na uron mirseardhjen, na pyet në se kemi ndonjë nevojë ose dëshirë, na adreson ku të shkojmë për nevojat dhe dëshirat që mund të kemi.

* * *

Ditët e udhëtimit tonë mbaruan. Rreth 11.000 metrat e filmave të zgjedhura në arkivat gjermane për shkëmbime reciproke janë shpërblimi i një pjese sado të vogël të besimit që na u dha.Sigurimi i këtyre filmave dhe përvoja e fituar nuk është vetëm rrjedhojë e punës së gjerë kërkimore që kisha bërë më parë, por edhe rrjedhojë e ndihmës miqësore e të pakursyer që na dhanë kolegët tanë gjermanë, preokupacioni i të cilëvet vazhdoi edhe mbas largimit tonë.Disa ditë pas largimit tonë zoti Eberhard Spies na shkroi:

- Ditët në Berlin rrodhën aqë shpejt sa që u kujtova tepër vonë se ju tashmë ishit larguar. Më erdhi shumë keq për këtë, mbasi kisha dëshirë që t'iu ftoja në një darkë në qytetin tim të lindjes.....Sidoqoftë le të presim një rast tjetër. Shpresoj se ky rast do të na jepet në Kongresin e Paris-it vitin e ardhëshëm...Kam siguruar disa matëriale të tjera mbi Moisiun dhe filmat e tij dhe mendoj se do t'ju shërbejnë... I juaji sinqerisht...E.S.

Këto matëriale me vlerë ai na i dërgoi.

Faleminderit kolegë.

Mirupafshim në Atdheun tonë të bukur.

Berlin 17 Maj 1987

Das schwarze Los



ALEXANDER MOISSI



Auf der Flucht

DAS SCHWARZE LOS

In der Commedia dell' arte ist der Kampf um das Weib der Mittelpunkt der Handlung. Colombina, die Gattin des alten, dicken Pantalone, an dessen Seite sie ihres Lebens nicht recht froh wird, ist das von Arlechino und Bajazzo heißbegehrte Objekt. Auf einem Spaziergang an der Seite ihres Gemahls begegnet sie Bajazzo zum erstenmal. Der jugendliche fahrende Gesell macht zum Verdruß des alten Pantalone einen so starken Eindruck auf sie, daß es bald zu einer geheimen Zusammenkunft der beiden kommt.

Nach mancherlei ergötzlichen Zwischenfällen, in denen der alte Pantalone die komische Rolle des gehörnten Ehemanns spielt, beschließen die Liebenden zu fliehen. Alles ist gut vorbereitet, Pantalone hat nach altem Brauch mit


Aleksandër Moisi dhe Johana Terwin/Moisi/
në filmin "**Das Schwarrze Los**"**/Fati i zi**",1912-13



Pamje të Budapestit



Frankfurt-Qytet i vjetër


FRANKFURT



Me vajzen Diana-Frankfurt,1997 Alte Opera




Pamje nga bregu i lumit Rhin



Kështjellë pranë Frankfurtit



Lugina e lumit Rhin



Berlin,Reichstag



Berlin-Unten den Linden



Berlin-Portat e Brandengurgut



A.Hoxha, E.I.Kruger, A.Keta-Berli



A.Hoxha, E.I.Kruger-Berlin 1987



ABAZ HOXHA

FILMI ARTISTIK SHQIPTAR

filmografi

Një zbulim befasues në Kopenhagen

Një princeshë e Ilirisë në qëndër të një filmi danez

Në dhomën tonë të pritjes, në Tragjas, kishin ardhur disa shokë të babait dhe ishin shtruar në muhabet.Unë dhe Kujtimi,vëllai im më i madh, herë pas herë vërtiteshim nëpër shtëpi,hynim e dilnim nëpër dhomë.Babai im,Tahir Hoxha,mësues dhe drejtor i shkollës së fshatit, po u fliste atyre në një çast për disa shtete të largëta që quheshin Skandinavi.Kjo m'u duk si një përrallë më tërhoqi vemëndjen dhe u ula në karrike dhe po dëgjoja tregimet e babait.Ai përmëndi emrin e një fisi që më tingëlloi si legjendë,fisin e Vikingëve,që më mbeti në mend për shumë kohë.Kur shkova në Vlorë në shkollën tregëtare në vitin 1941, një ditë një mik i babait m'u afrua përshëndeti e më puthi dhe më mori për dore në dyqan ku më bleu një çokollatë.Mbasi ai u largua e hapa letrën mbështjellëse dhe më befasoi një fotografi e një vajze të bukur me sy të përgjumur, shikim depërtues që të rrëmbente me shikimin e saj.Mbrapa saj ishte shkruar Greta Garbo.E shikova gjatë këtë fotografi,disa herë gjatë ditës, dhe kur ua tregova shokëvet të shkollës ata më rrethuan dhe më vunë në mes të habitur nga fati që kisha patur që më ra në dorë kjo fotografi e rallë.Djemtë e qytetit që kishin pasur mundësi të shifnin shumë filma e dinin kush ishte Greta Garbo ndërsa unë, deri në atë kohë, nuk kisha parë asnjë film.Pa dashur u bëra njeriu i ditës.Më ofronin shumë fotografi të tjera në shkëmbim me Greta Garbon,dikush Carli Caplinin dhe dy aktorë të tjerë vetëm për Gretën.Të them të drejtën as aktorët e tjerë nuk i kisha dëgjuar se vija nga fshati dhe filma nuk kisha parë ende,por befas e ndjeva veten të privilegjuar që kisha në dorë një pasuri të rrallë.Një djalë më i madh tha se kishte parë në Fier një film që titullohej "*Mbretëresha Kristinë*" ku rolin kryesor,atë të mbretëreshës, e luante Greta Garbo.Ishte një histori

e rrallë kur mbretëresha e Suedisë largohej nga froni për të shkuar me një të dashurin e saj.Ky tregim më afroi më shumë me këtë virtyt të lartë që e ngrinin në piedestal skandinavët,për vlerësimin e dashurisë mbi çdo gjë.Vikingët,Greta Garbo dhe Suedia u bënë për mua personifikim i legjendës,bukurisë dhe dashurisë së pastër që mbi çdo gjë vinin njeriun dhe jo pasurinë.As nuk më shkonte ndërmend atëhere se do lidhesha aqë shumë me ato vende të largëta dhe me Greta Garbon për të cilën do të shkruaja edhe librin "*Vajza që u kthye në legjendë*"(2003).

Shumë vite më vonë,kur studioja në Universitetin e Pragës,pashë atje një film suedez me titull:"*Kërceu vetëm një verë*" ku rolin kryesor e luante aktorja Ula Jacobson.Ishte një film subjekti i të cilit kishte në qëndër kritikat karshi autoriteteve dhe klerit në një qytet provincial dhe përsëri në qëndër ishte edhe dashuria e pastër që sundonte midis dy të rinjve që loznin rolet kryesore.Pra përsëri ndjenjat njerëzore.Filmi,për tematikën që trajtonte dhe realizimin artistik kishte tërhequr vemëndjen e kritikës dhe spektatorëve jo vetëm në çekosllovaki por kudo që ishte shfaqur,dhe siç do ta merrja vesh më vonë i realizuar nën influencën e neorealizmit italian.Po të njëjtin vit ndoqa një film dokumentar që tregonte për Kampionatin Botëror të Hokejit që zhvillohesh në Suedi.Më bënë përshtypje disa kuadro që jepnin fusha të tëra me parkimin e mijra biçikletave dhe sipër tyre çantat e pronarëve që qëndronin me ditë të tëra mbi to dhe nuk i prekte njeri.Dikush me tha se në vendet skandinave prej mbi 100 vjetëve nuk egziston vjedhja,mbasi dikur një mbret suedez nxori një ligj që kur vërtetohesh se kishe vjedhur të pritesh dora.Dukesh si ligj makabër por në vite ajo u bë një edukatë e qytetarëve për të hequr nga lista e veseve të këqija fenomenin e vjedhjes jo vetëm për faktin se të pritesh dora por më tepër për arsye se ishte një dënim moral që të ndiqte pas gjithë jetën se kur të shikonin të tjerët me dorë të prerë donte të thoshte se dikur ke vjedhur.Më vonë më ranë në dorë disa nga

përrallat e shkrimtarit danez Hans Kristian Andërsen që ishte bërë mjaft i njohur në botë me veprat e tij shumica e të cilave ishin shndrruar edhe në filma dhe figura e tij ishte shndruar në një simbol të tregëtimtarit më të madh.

Të gjitha këto,tregimet e babait për skandinavinë dhe Vikingët,portreti i Greta Garbos,virtytet e dashurisë së pastër dhe dënimi i vjedhjes si një cen i shoqërisë njerzore,filmi "*Kërceu vetëm një verë*" dhe sidomos përrallat e Andersenit më krijuan një vizion adhurues për vendet skandinave.Dhe kur vite më vonë Ndoc Gjetja më dha për reçencë një shkrim për kinematografinë e vendeve skandinave e mora me kënaqësi.Por tashmë kisha filluar të merresha me historinë e kinemasë botërore dhe kisha lexuar pak edhe për kinemanë skandinave dhe u pasionova pas saj mbasi ishte një nga të parat që kishin lënë gjurmë të thella në historinë e kinemasë botërore.Kur e lexova shkrimin,të them të drejtën u revoltova me autorin mbasi ai,në mungesë të njohurive në këtë fushë,kishte shumë gjëra të pasakta që shkonin deri në mohim të vleravet të saj.Kjo e kishte burimin se artikullshkruesi,duke mos e njohur kinematografinë, ishte mbështetur në burime të shteteve të mëdha të cilat përgjithësisht kanë tendencën e injorimit të vlerave të vendeve të vegjël,pra i denigrojnë ato. Për këto arsye e quaja shkrimin e autorit si denigrues për kinematografinë prestigjioze skandinave.Kryeredaktori i revistës "Skena dhe Ekrani", N. Gjetja, duke u mbështetur në mendimet e mija dhe duke më njohur tashmë si të vetmin studjues në fushën e historisë së kinematografisë, nuk e botoi shkrimin. Në kërkimet në shtypin shqiptar të viteve 1920-'30 gjeta shkrime edhe për kinematografinë skandinave si dhe për regjisorët M. Stiller dhe V. Sjostrom, K.Th. Drajer dhe sidomos për aktoren e madhe Greta Garbo, etj Kjo më bëri që të futesha më thellë në studimin e historisë së kinemasë të vendeve skandinave ku zbulova vlera të mëdha dhe pas një viti botova shkrimin tim të gjatë "*Kinematografia e*

vendeve skandinave"të cilin, me disa ndryshime, e botova në vitin 2003 edhe në një libër të veçantë me të njëjtin titull.

Siç kam përmendur në nënkapitujt e mësipërm, kisha vite që merresha me kërkime në fushën e historisë së kinemasë në Shqipëri.I fillova këto kërkime me një farë pesimizmi mbasi edhe unë isha rritur me psikologjinë se çdo gjë lindi në Shqipëri vetëm mbas çlirimit të vendit.Kështu thoshte propaganda e kohës.Por u nisa dhe me një vullnet dhe sedër për të zbuluar çdo gjë,qoftë edhe e vogël që kishte të bënte me vendin tim.Dhe puna e ime e gjatë dhe e mundimshme kërkimore nuk më zhgënjeu..U futa thellë në arkivat bibliotekat shqiptare dhe të huaja dhe për çdo gjë që zbuloja më shtohesh krenaria e vendit t'im.Gjeta shumë gjurmë të kronikave të shoqërive të ndryshme kinematografike evropiane të xhiruara në Shqipëri nga fillimi i shekullit të kaluar.Pothuajse gjithë kineastët e vendeve evropiane kanë xhiruar në Shqipëri që nga të parët,përfaqësonjësit e shoqërisë kinematografike angleze "Charls Urban Company"(1903), shoqëritë e mëdha franceze "Pathe" e Gaumont",italiane "Cines" dhe "Unitas"që e ka filluar krijimtarinë e saj me xhirimin e filmit "*Albania ribelle*"(1909),shoqëritë austriake "*Sascha Filmfabrik*" dhe"*Wiener Autoren-Film*"(nga 1913), shoqëri gjermane, zvicerane, amerikane, daneze,hollandeze e deri tek ato ruse. Por përveç qindra kronikave të xhiruara në trevat tona janë xhiruar edhe disa filma artistikë,me interpretim,duke filluar nga dekada e parë e shekullit të kaluar.

Nuk më shkonte ndërmend që në Danimarkë të xhirohej një film artistik që në vitin 1922 në qëndër të të cilit ishte Iliria dhe një princeshë Iliriane.Kjo më tërhoqi vëmëndjen dhe u mundova të gjeja shkaqet që një vend i largët i veriut të vinte në qëndër të subjektit të filmit Ilirinë.Zbulova se kjo nuk ishte një rastësi dhe se filmi danez hidhte dritë mbi disa lidhje të lashta të vëndeve skandinave me Ilirinë dhe origjinën e shqiptarëve.Nuk mund të lihet në harresë fakti që albanologët e parë janë skandinavët.

Kështu p,sh **Hans Erich Thunmann** (1746-1778) historian suedez,ishte një nga albanologët e parë,profesor në Universitetin e Halles në Gjermani.Njohja me studentë e tregëtarë nga vendet e Evropës Lindore dhe Jugëlindore,midis tyre edhe me shqiptarë, i nxiti interesin për të studiuar gjuhën e historinë e atyre vendeve.Në veprën "*Hulumtime për historinë e popujve të Evropës Lindore*"(1774) që nuk e ka humbur ende vlerën,në një nga kapitujt kryesorë H.Tunman bën përpjekjen e parë shkencore për të shpjeguar prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Ai arrijti në përfundimin se shqiptarët mesjetarë janë vazhduesit autoktonë të popullsisë antike të ilirëve,e cila nuk u romanizua si ajo dako-trake paraardhëse e rumunëve,as nuk u zëvendësua në viset e veta nga një popullsi e mëvonëshme e dyndur këtu.Duke u mbështetur në burimet bizantine,ai jep historinë e shqiptarëvet mesjetarë si një formacion etno-kulturor unitar dhe si faktor politik më vehte.

Edhe **Holger Pedersen** (1867-19539).- gjuhëtar i shquar danez,indoevropianist me interesa shkencore të shumanëshme,profesor në Universitetin e Kopenhagës,autor i një vargu veprash dhe studimesh me vlerë,vëmendjen kryesore në fillim ia kushtoi gjuhës shqipe,por më pas u mor me gjuhë të tjera,sidomos me keltishten,armenishten etj,duke dhënë ndihmesa të rëndësishme.Më 1883 vizitoi Shqipërinë e Jugut.Për gjuhën shqipe ka botuar disa studime me vlerë si:"*Kontribut për historinë e gjuhës shqipe*"(1894), "*Tingujt **i** të shqipes*"(1897),"*Asnjanësi i shqipes*"(1899), "*Grykoret në gjuhën shqipe*"(1900),etj. Edhe danezi tjetër **Kristian Sandfeld-Jensen**(1873-1942),nxënës i Pedersenit,mbas studimeve të gjata e përcaktoi gjuhën shqipe si një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit.

Në këtë afeksion të studjuesvet skandinavë për prejardhjen e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe u përfshinë dhe shkrimtarët,dramaturgët dhe kineastët skandinave.

Kështu dramaturgu **Holger Drachman** në vitin 1883 shkroi dramën "*Na ishte një herë*"/Der Var Engang/,e cila u shfaq me sukses dhe u bë mjaft popullore në teatrot e Kopenhagenit që në ato vite.Kjo dramë është mbështetur në tregimet e shkrimtarit të madh danez Hans Kristian Andersen me titull "*Svidrengen*" dhe në komedinë e dramaturgut të shquar Villiam Shekspir "*The Taming of the Shrew*"/Mposhtja e kryeneçes/.Komedia shekspiriane *"The Taming of the Shrew"* është publikuar për herë të parë në vitin 1623 dhe mbështetur në të janë bërë edhe disa filma nga shoqëri të ndryshme kinematografike me tituj të ndryshëm si: "*Kiss me Kate*" në vitin 1948 dhe varianti muzikor me titullin origjinal "*The Taming of the Shrew*" me interpretimin e aktorëve të shquar Elisabet Taylor (në rolin e princeshës)dhe Richard Burton, në vitin 1953.

Mbështetur në këtë dramë regjisori i madh danez **Karl Theodor Drejer** xhiroi në vitin 1922 filmin me të njëjtin titull "*Der Var Engang*"/Once Upon A Time" që në shqip do të thotë "*Na ishte një herë*".Ky film-përrallë u shfaq si premierë më 3 tetor 1922 në teatrin "Palads" te Kopenhagenit dhe pati mjaft sukses.Në qëndër të filmit është mbreti dhe princesha e Ilirisë dhe një princ danez që kërkon dorën e saj dhe tregon të gjitha peripecitë që bën ai për ta shtënë në dorë princeshën e bukur por mospërfillëse, indiferente dhe kryelartë iliriane.

Eshtë një film përrallë dhe fillon me tekstin:

..Një herë e një kohë na ishte një mbretëri që quhesh Iliri…shumë larg,në anën tjetër të detit….Princesha e Ilirisë ishte bërë e njohur gjërësisht për bukurinë e saj por ajo ishte krenare dhe e ftohtë(indiferente).Admiruesit e saj nuk kishin sukses dhe ajo i përçmonte…

Ishte koha kur kinemaja daneze ishte në pararojë të kinemasë botërore dhe filmat e shoqërive të tyre kishin depërtuar deri në Sh.B.A ku kishte edhe një agjenci për shpërndarjen e

tyre.Filmat danezë e suedezë ishin nga më të preferuarit dhe regjisorët skandinavë të këtyre viteve,si K.T.Dreyer,V.Sjostrom, M.Stiler,B.Kristiansen etj kanë zënë vënd në historinë e kinemasë botërore si klasikët e kinemasë botërore të periudhës së filmit pa zë.

Dihet se në atë kohë filmat ishin pa zë prandaj figura shoqërohet me tekst në sekuencat e tij dhe me një muzikë në sfond.Në rolin e princeshës së Ilirisë interpreton aktorja e njohur daneze Klara Weith(Pompopidan) dhe Svend Methling,në rolin e princit danez.Filmi është prodhim i shoqërisë kinematografike "Sophus Madsen Film",xhiruar nga kinooperatori George Schneevoight dhe me shoqërim muzikor të Neil Brand, zgjat 75 minuta dhe me titra danisht ose anglisht.

Kisha vite që e kërkoja këtë film mbasi titullin e tij e kisha gjetuar që në vitet 1980 dhe e kam përmendur në shkrimin e gjatë që botova në revistën "Skena dhe ekrani"me titullin "*Kinematografia e vendeve Skandinave*"dhe më vonë në librin me të njëjtin titull që botova në vitin 2003.Por dija vetëm titullin,pra kisha vetëm gjurmët e tij,më duhesh të bëja përpjekje të gjeja vetë filmin dhe kjo ishte e vështirë

Siç përmënda më lart unë kisha krijuar një afeksion të veçantë për vendet skandinave për kulturën e tyre të lashtë,për figurat e shquara në letërsi,për natyrën paqësore dhe zhvillimin e madh në të gjitha fushat.Ndoshta ky afeksion ishte refleks i reciprocitetit.Për këtë u lidha me Ambasadën e Mbretërisë së Danimarkës një vit më parë dhe me dashamirësinë dhe përkrahjen e pakyrsyer të zotit Finn,ish Charge d'Affair, dhe me ndihmën e një miku t'im që më sponsorizoi udhëtimin,u bë e mundur të shkoja në Danimarkë dhe të vizitoja Institutin danez të filmave. Ky film bën pjesë në koleksionin e plotë të regjisorit të njohur danez dhe fatmirësisht është i ruajtur në origjinal me pak mungesa në fundin

e tij.Një kopje të këtij filmi në DVD e mora në filmotekën e Institutit Danez dhe e ruaj si një koleksion të rrallë.

Rëndësi e madhe e këtij filmi nuk ka të bëjë vetëm me faktin se ka në qëndër një princeshë iliriane dhe që interpretohet nga aktorë të shquar danezë por mbi të gjitha se ai është i pari film artistik me subjekt mbi vendin tonë i gjetur gjer më sot dhe i xhiruar nga një regjisor i madh botëror që në vitin 1922.

* * *


Carl Theodor Dreyer (03.02.1889-20.03.1960).Lindi dhe vdiq në Kopenhagen.Regjisor i madh danez dhe një nga regjisorët më të shquar evropianë.Nënën e kish me origjinë suedeze.Filloi si nëpunës në një shoqëri transporti.Më vonë u muar me kritikën e teatrit fillimisht në gazetat provinciale e më vonë në të përditëshmet e Kopenhagenit *Berlingske Tidende* dhe *Extrabladet*.Më 1912 u lidh me filmin si autor i titujve për shoqërinë Nordisk.Në vitin 1918 kalon në të gjithë sektorët e filmit.Po këtë vit xhiron filmin e tij të parë "*President*"(Praesidenten) realizuar sipas romanit të Karl Emil Franzos.Në vitin 1920 xhiroi filmin e dytë "*Fletët e librit të Satanit*" i inspiruar nga filmi "*Intoleranca*" e regjisorit të madh amerikan David WarkGriffith.Përvoja e fituar e çoi në realizimin e kryeveprave të tij "*Pasioni i Zhana D'arkut*" dhe "*The day of Wrath*"/Dita e urrejtjes.

C.T.Dreyer është një nga mjeshtrit më të padiskutuar të historisë së kinemasë.Ai xhiroi vetëm 14 filma gjatë jetës së tij por ato vepra përfaqësojnë fazat kryesore të zhvillimit të kinemasë nga filmi pa zë tek ai me zë,prej vitit 1918-1964.Ai konsiderohet një nga figurat më të shquara jo vetëm të kinemasë skandinave e franceze, ku ka xhiruar disa filma, por të kinemasë botërore përgjithësisht.Shumë prej filmave të tij shifen edhe sot,jo vetëm nëpër arkivat dhe klubet e filmave dhe në universitetet,por edhe nëpër kinematë ku shfaqen vepra arti.Një vëmëndje të veçantë

shikuesit e ndryshëm kanë kushtuar kryeveprës së tij të periudhës së filmit pa zë "*Pasioni i Zhana D'Arkut*"(1928).

Një nga veprat e tij të viteve të fillimit është edhe filmi "*Once Upon A Time*"(Na ishte një herë,1922) që është mbështetur krejtësisht në ngjarje dhe treva të Ilirisë së lashtë.

* * *




Carl Theodor Dreyer (03.02.1889-20.03.1960)



Klara Pontoppidan/Princesha e Ilirisë/



Na ishte njëherë (në rolin e mbretit)



Na ishte një herë/Once upon a Time,1922/



Princesha e Ilirisë/Once Upon a Time,1922/



Princi i Danimarkës&Mbreti i Ilirisë/Na ishte një herë/





Enrica Fantis/Kushërira nga Shqiperia,1927/



Kalorësi i Krujës,1941



La conquista d'Albania/film spanjoll,1983/

Odisea e një libri

Paralelisht po punoja për botimin e dy librave**.** Librin e parë e kisha bërë gati për shtyp. Sigurisht që nuk mund të filloja me botime për të kaluarën, d.m.th para çlirimit për arsyet që kam përmendur disa here. Duhej te shkruhej kryesisht për arritjet në "Kohën e Partisë". Kisha kohë që e kisha filluar përgatitjen e këtij libri që kishte të bënte me historinë e kinematografisë shqiptare por që isha përqëndruar kryesisht në filmin artistik shqiptar.Kishte disa vjet (1965) që, me nisiativën time,u krijua një grup, ose redaksi, për hartimin e tekstit të plotë të historisë së kinematografisë shqiptare. Në krye të këtij grupi qëndronte regjisori Kristaq Dhamo që atëhere kryente funksionin e udhëheqsit artistik të kinostudios. Në këtë redaksi bënin pjesë përveç Kristaqit e meje edhe Viktor Gjika, Piro Milkani, Todi Bozo e mesa më kujtohet edhe Dhimitër Anagnosti e Niko Koleka (ky i fundit në atë kohë punonte në redaksi). Bëra disa here përpjekje që kjo redaksi të mblidhesh dhe të fillonte nga puna dhe në fakt u mblodhëm disa here por bëheshin vetëm diskutime parimore dhe nuk u bë asgjë konkrete.

Atëhere unë fillova të shkruaja vetë. Grumbullova informacionin e nevojëshëm për filmin artistik si dhe matërialet që kishin të bënin me krijimin e Ndërmarrjes Kinematografike Shqiptare, Kinostudios "Shqipëria e re" si dhe me një punë shumë të lodhëshme në shtypin e kohës për të grumbulluar jehonën e filmit shqiptar deri në atë kohë nëpërmjet shtypit të asaj periudhe. Në vitin 1980 e kisha përfunduar librin me titullin "*Filmi Artistik Shqiptar*" i cili përveç një filmografie të plotë kishte edhe një vështrim të shkurtër mbi fillimet e kinematografisë shqiptare deri në atë periudhë. Aty përfaqësoheshin të gjitha filmat e xhiruara nga viti 1953 (Skënderbeu) e deri në vitin 1980. Një kopje të daktilografuar të librit ia dorëzova drejtorit të kinostudios për të

marrë edhe mendimet e tyre. Ai ia dorëzoi ish udhëheqsit artistik. Prisja të më thërrisnin për mendimet e tyre dhe vrejtjet. Pashë që punimi im shkaktoi një reagim të heshtur dhe një zili. Justifikimet koridoreve ishin se historinë e kinemasë do ta bënte grupi që ishte ngritur i cili siç permënda prej disa vjetësh nuk kish funksionuar fare. Pas një vit e gjysëm më thirri udhëheqësi artistik e më dorëzoi kopjen në pamje me fjalë të mira por që më përsëriti se historinë duhej ta bënte një grup më i gjërë, se duhej të ishte bërë kështu dhe ashtu por pa asnjë mendim konkret.Atëhere iu drejtova përsëri drejtorit të kinostudios duke i kërkuar ta dërgonin zyrtarisht librin tim në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori" si një botim të kinematografisë,ndërsa redaksia e krijuar të vazhdonte punën për të bërë një botim më të gjerë. Mendimi im u miratua prej tij dhe libri u nis zyrtarisht në Shtëpinë Botuese me kërkesën për tu botuar.

Por nuk ishte e lehtë të botoje një libër.Vepronte censura. Dhe një ditë më vonë më vjen një redaktor i Shtëpisë Botuese me një sëri vrejtjesh të cilat duhej të koregjoheshin pa tjetër ndryshe libri nuk botohej. Këto vrejtje ishin:

1.- Të hiqen nga libri filmat "*Skënderbeu*" dhe "*Furtuna*" që ishin bashkëprodhime me kinematografinë sovjetike me të cilët në atë kohë ishin marrdhënie të acaruara shtetërore dhe partiake dhe konsideroheshin nga ne "revisionistë"

2.- Drejtoria e kinostudios të bënte një prononcim me shkrim se të gjitha filmat e vendosur në libër ishin në qarkullim në rrjetin e kinemave dhe se duhej të mbahej përgjegjësi nga ana e saj në rast të kundërt.

3. Të mbahej përgjegjësi e plotë në se në libër kishte persona të "padëshëruar" aktorë, regjisorë, skenaristë etj të cilët ishin dënuar ose internuar nga regjimi- dhe të tillë kishte.

Redaktori J.T.erdhi tek unë. U përpoqa ta bindja se unë nuk shfaq filmat në kinema por po bëj një libër që të evidentoj gjithë krijimtarinë në fushën e filmit artistik të prodhuar deri atëhere

dhe se këto ishin të dhëna të domosdoshme për një libër të tillë ku të përfaqësoheshin filmat me autorë e interpretues ashtu siç jepen në kopertinat e filmave. Ishte e kotë. Ai ishte i vendosur dhe i prerë se filmat e prodhuar në bashkëpunim me kinematografinë sovjetike nuk duhej të vendoseshin se autorët dhe interpretuesit ruse ishin revizionistë dhe ne nuk kemi marrdhënie me Bashkimin Sovjetik. Kjo ishte kërkesë e prerë. Po kështu duhej të hiqeshin nga libri filmat: "*Detyrë e posaçme","Vitet e para", "Ngadhnjim mbi vdekjen", "Prita", "Përse bie kjo daulle", "Gjurma*", etj se në këta filma interpretonin ose ishin në kopertina e tyre si autorë: Xhemal Broja, Halim Xhelo, Xhevat Alibali, Edi Luarasi, Lluk Kaçaj, etj të cilët ishin dënuar, burgosur ose internuar si "armiq të Partisë dhe të popullit".

Libri m'u kthye që ti bëheshin koregjimet përkatëse. Drejtoria e kinostudios nuk pranoi të japë përgjigje me shkrim se në libër nuk ishin përfaqësuar dhe më kërkuan mua po me shkrim që i kam bërë këto koregjime. U përpoqa disa here për ti bindur se në libër duhej të përfaqësohej krijimtaria kinematografike e gjithë dhe ashtu siç jepesh në titujt e filmave mbasi kjo kishte të bënte me historinë e filmit. Por me që nuk po çaja dot u detyrova të hiqja filmat "*Skënderbeu*" dhe "*Furtuna*" dhe emrat e autorëve dhe interpretuesve që ishin të dënuar dhe e dorëzova përsëri librin.

Pas disa ditëve më thirrën përsëri dhe me tone të ngritura më kërcënuan se do tu drejtoheshin Ministrisë dhe Komitetit Qëndror të Partisë se unë doja të propagandoja armiq.Unë u thashë që emrat e tyre i kam hequr. Më kërkuan që të hiqja edhe filmat sepse njerzit e dinë që në ato filma ata kanë interpretuar dhe prunë si shëmbëll aktoren Edi Luarasi e cila kishte interpretuar në "*Ngadhnjim mbi vdekjen*" dhe disa filma të tjerë. U thashë se E.Luarasi nuk është në burg ajo punon në një qëndër pune së bashku me puntorë të tjerë që nuk janë armiq.Si mund të konsiderohet armik kur punon me të tjerë puntorë të pararojës.Mbas

përpjekjeve gjashtë muaj më në fund i binda që këto filma të mos hiqeshin dhe e paraqita përsëri librin.

Po atë ditë më morën përsëri në telefon dhe më kërcënuan se në libër ishte emri i Bashkim Shehut dhe Lirim Pullumbit të cilët ishin në kopertinat e filmave si skenarist ose bashkautor skenari në filmat "*Skëterrë '43*" dhe "*Një ndodhi në port*", filma që ishin prodhuar në vitin 1980. Përsëri m'a kthyen librin. Pas gjashtë muajve u detyrova ti heq këto të dy filma dhe e paraqita përsëri librin për botim. Fillimisht më këshilluan që librin ta botoja si katallog me fotografi dhe me një hyrje të shkurtër gjë të cilën nuk e pranova. Më në fund, aty nga viti 1985 libri u fut në procesin e redaktimit për tu bërë gadi për shtyp i plotësuar tashmë edhe me filmat e viteve 1981-1984. Por nuk zgjati shumë dhe më thirrën përsëri këtë radhë me tone shumë të ashpra se në libër ishin emrat e Petro Markos dhe të Lirim Dedes të cilët kishin bërë nga një shkrim për filmin shqiptar dhe ishin të dënuar (për ta bërë të plotë librin dhe për tu shërbyer studjuesve unë në libër kisha vendosur edhe bibliografinë e shtypit për filmin dhe kinematografinë).

Këtë radhë librin jo vetëm që e kthyen përfundimisht por me anën e një letre prej pesë faqesh të daktilografuara ju drejtuan Drejtorisë së Shtypit të Komitetit Qëndror, Komitetit të Partisë së Tiranës, Ministrisë Arsimit dhe Kulturës dhe Drejtorisë së Kinostudjos me anën e të cilës më akuzonin me termat më të ashpëra si mos njohës së vijës së partisë dhe mbështetës të elementëve të pa dëshëruar armiq të Partisë dhe të Popullit. Të ishin marrë seriozisht terminologjija e asaj letre proteste mua duhej të më kishin varur në mes të Tiranës (letra gjëndet pranë arkivit administrativ të kinostudios). Drejtori i Kinostudios më thirri menjëherë në një mbledhje urgjente ku ishte edhe sekretari i Partisë, shefi i propagandës dhe zv/drejtori që drejtonte propagandën e filmit në Kinostudio.Drejtori i shqetësuar dhe i trembur sa që kur

lexonte i dridheshin duart, mbasi e lexoi deri në fund letrën m'u drejtua:

-Ç'është ky libër, unë nuk jam në dijeni??

E shikova me vëmëndje dhe me keqardhje për frikën që i kishte hyrë deri në palcë dhe iu përgjigja:

- *Ti je në dijeni, shoku drejtor, se ke firmosur edhe shkresën përcjellëse për Shtëpinë Botuese dhe unë ju kam vënë në dijeni për protestat e mija. Megjithatë ti nuk ke pse të shqetësohesh, librin e kam shkruar unë dhe jo ti, prandaj mos kij merak. Unë përgjigjem për të. Por me që më thirrët unë nuk i heq më asnjë presje librit se unë dua ta shkruaj historinë e kinematografisë jo të deformuar dhe të cunguar por ashtu siç është. Kjo është edhe në nderin tuaj.*

Dhe u ngrita të largohesha i revoltuar. Në koridor ai më ndoqi nga pas dhe filloi të më bënte thirrje që ta tërhiqja librin dhe të mos hapja telashe se edhe po të botohesh libri po të dilte ndonjë emër i padëshëruar do ta digjnin në kaldajë.

I thashë se kur libri të botohet, le të digjet, por kopjet e Bibliotekës Kombëtare do të mbeten dhe historia e kinemasë shqiptare do të jetë atje.Mos u preokuponi për një libër qe edhe po të digjet kushton rreth 500.000 lekë por shifni mos bëni ndonjë film me probleme i cili nuk koston kaq por mbi 15 milion lekë.

Më tha se ti je kokëshkretë dhe do thyhesh kokën.

Mbas shumë peripecish dhe përpjekjet këmbëngulëse të mijat,sikurse edhe nga një shprehje e një revolte të hapur në mbledhjen e përgjithshme të Kinostudios për analizën vjetore ku kish ardhur edhe ministrja e Arsimit dhe Kulturës dhe Zv/ministri,dhe me ndihmën e Z.S.Çela që në atë kohë ishte zv/minister i kulturës libri u shtyp në vitin 1987 në variantin shqip dhe u fut për shtyp edhe në anglisht për tu shërbyer edhe të huajve.

Por maratona nuk mbaroi me kaq. Mbasi libri ishte shtypur, siç ishte rregull, një kopje iu dërgua edhe Sekretarit të Parë të K.Q. të Partisë Ramiz Alia. Ai sa e mori në dorë dhe e flaku në dysheme duke thenë:

-*Ç'është ky libër lluksoz më i mire se veprat e shokut Enver*!?(mbasi libri kishte kopertinë të forte dhe disa tregues në letër me ngjyra në fund).

Kjo mjaftoi që të shpallesh alarmi në administratën shtetërore, të pezullohesh varianti anglisht dhe unë të trajtohesha si njeri i dyshimtë. Kulmi ishte kur gazeta "Zëri i Popullit" bëri një njoftim ku jepte edhe përmbajtjen e librit dhe ndonjë vlerësim duke e cilësuar si librin e pare të kinematografisë shqiptare. Më thirrën në ministri dhe më kërcënuan pse unë të propagandoja një libër që ishte kritikuar. Unë iu përgjigja se shkrimin nuk e kam bërë unë dhe se "Zëri i Popullit" nuk varet nga unë por nga Komiteti Qëndror i Partisë.Por unë nuk di asgjë që libri është kritikuar dhe përse është kritikuar.

Megjithatë harrijta të tërheq nga shtypshkronja variantin anglisht të librit i cili kishte filluar botimin por po përdorej nga puntorët për mbështjelljen e bukës ose si ambalazh.

Para se libri të dilte në qarkullim shkoi një delegacion në Panairin e Librit në Leipcig. Në këtë delegacion bënte pjesë edhe një punonjës i Drejtorisë së Shtypit të Komitetit Qëndror. Meqënëse ky ishte i pari libër për kinematografinë, që atëhere kishte marrë zhvillim dhe konsiderohej një nga arritjet më të mëdha të periudhës së socializmit në fushën e kulturës, dhe libri kishte një paraqitje të mire nga jashtë ata morën rreth 200 kopje me vehte. Atje libri kishte patur jehonë dhe ata erdhën të entusiazmuar për suksesin e panairit shqiptar duke mos dijtur se këtej kishte rënë rrufeja nga kreu i shtetit. Megjithatë libri, që u botua në 3000 kopje u lejua të hidhesh në qarkullim dhe në publik bëri jehonë si libri i parë për kinematografinë shqiptare dhe brënda muajit u shitën rreth 2000

kopje. Një paradoks i vërtetë. Ndërsa shumë kineastë, kritikë dhe dashamirës më përgëzonin për këtë botim të plotë për filmin artistik shqiptar, shtypi, radio, televizioni heshtëte. Kritiku Xh.Abazi kur e pa librin më tha në një bisedë intime:

-Deri tashti ne kritikët nuk kemi shkruar për filmin duke u justifikuar se nuk kemi informacionin e nevojshëm ku të mbështetemi. Tashmë na e ke hequr këtë armë me këtë libër që ka informacion të plotë.

Pati edhe njerëz që e pritën me zili dhe që në një fare mënyre iu bë qejfi për heshtjen. Këtë zili dikush e shprehte me hedhjen e mendimit pse të shkruajë një inxhiner për kinemtografinë, studimet për artin duhet ti bëjnë kineastët etj, etj. Këta ziliqarë mezi prisnin që libri të shkaktonte ndonjë problem, që të dilte ndonjë njeri i pa deshëruar dhe bashkë me librin të fluturoja edhe unë.

Por këtë heshtje të plotë e theu shoku dhe miku im Luan Rama, në atë kohë udhëheqës artistik i kinostudios, i cili bëri një shkrim të gjatë në gazetën "Drita"-organ i Lidhjes së shkrimtarëve dhe e vlerësonte librin. Kjo ishte një kurajo e madhe për të, por L.Rama është dalluar për njeri kurajoz se ishte një intelektual dhe studjues i mirëfilltë vetë, ishte edhe një nga skenaristët dhe kritikët me krijimtari më të madhe. Për ta vërtetuar këtë nuk mund të rri pa përmendur faktin që kur unë u përjashtova nga Partia dhe Luani punonte në Ministrinë e Punëve të Jashtëme, ai ishte i pari dhe i vetmi që më erdhi në shtëpi për të më dhënë kurajo. Dhe kjo përbënte një rrezik të madh për atë dhe familjen e tij, mbasi siç dihet kush përjashtohesh nga Partia konsiderohesh "Armik i Partisë dhe i Popullit".

E botova pas një pune shumë të lodhëshme, por në vend që të isha i gëzuar kisha një trishtim, një fare ndjenje faji që më ndiqte në çdo hap. Dhe kjo vazhdoi gjatë.

Një ditë më vjen Piro Milkani në arkivin e filmit ku punoja dhe më propozon që të më bënte një intervistë direkt në studion e

televizionit në një spetakël që ai do të fillonte bashkë me Elvira Liçaj (Dones). Ky spetakël prej shumë puntatash titullohej "*Mrekullia e artit të shtatë*", ku do të merrnin pjesë kryesisht të rinjtë dhe do të organizohesh edhe një fare "kuizi"për kinematografinë dhe filmin shqiptar dhe si bazë ata do të përdornin librin tim "*Filmi Artistik Shqiptar*", prandaj edhe në emisionin e pare duhej të flisja unë si autor i librit. Ndonse Piro ishte një njeri shumë dashamirës, m'u duk naïve nga ana e tij prandaj e shikova me shumë dyshim dhe i thashë:

Piro. Nuk e shef opinionin. Nuk do të lejojnë që të më intervistosh mua kur ka një opinion dyshues që në krye të pyramidës.

Më tha se atë punë do ta zgjidhte ai por nuk mund të zhvillohesh një konkurim i tillë pa qënë prezent burimi kryesor i informacionit ku do të mbështeteshin të rinjte- pra autori i librit.

-Hezitova shumë, i *thashë se edhe në rast se do të më intervistosh, intervista ime do të pritet dhe nuk do transmetohet*.

Megjithatë ai ma mbushi mëndjen dhe vajta në emisionin e pare dhe dhashë intervistën. Por doli ashtu siç e kisha parashikuar.Intervista ime nuk u transmetua.Tashmë kisha hyrë në radhët e të dyshimtëve dhe ata që drejtonin median nuk kishin kurajo të bënin një veprim që mund tu kushtonte karriken.Ishte opinioni i kreut të pyramidës, ndonse me sa di unë, ai nuk kritikoi librin, por tha vetëm se është një libër lluksoz, ndërsa një tjetër poshtë tij, për të qënë në unizon dhe për të forcuar karriken e quajti librin si një "listë gjellësh".

Megjithatë publiku nuk e përfilli opinionin zyrtar.Të tremijë kopjet e librit u shitën brenda një periudhe shumë të shkurtër, ndonse kishte një kosto shumë të lartë për mundësitë financiare të lexuesve në atë kohë. Ishte një ngjarje e veçantë, libri i pare për kinematografinë shqiptare që atëhere kishte filluar të krijonte një mendim shumë të mire në publikun shqiptar.

Kur u qetësuan gjakrat unë tërhoqa 150 kopje dhe ja u dërgova shumicës së Instituteve dhe arkivave filmike botërore që nga Argjentina në Australi.Libri bëri edhe jashtë jehonë dhe mora disa letra përgëzimi nga Anglia,Gjermania,Franca etj.Pati edhe ndonjë studiues që kërkonte edhe kopje personale.Ndër vrejtjet e tyre ishte e dallueshme që kërkonin të botohesh edhe në ndonjë gjuhë të huaj.Siç përmënda më lart libri ishte përkthyer në anglisht dhe kish kaluar në shtyp por reagimet e kreut të shtetit bënë që të pezullohesh botime dhe ta merrnin puntorët të mbështillnin bukën me atë pjesë që u shtyp.Fatmirësisht unë munda të tërheq origjinalin edhe me diapozitivat e fotografive.

Studjuesi anglez John Holstrom ndër të tjera më shkruante:

-"*Ju uroj gjithë të mirat për progresin në punën tuaj kërkimore në fushën e historisë së kinemasë shqiptare.Do të ishte një punë me shumë vlerë,dhe unë shpresoj se do të botohet edhe në anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër të njohur gjerësisht*

Ndërsa Eberhard Spies, zëvëndësdrejtor i Institutit gjermanoperëndimor i artit filmik me qëndër në Frnakfurt më shkruante:

-"*Libri i mbrekullushëm mbi filmin shqiptar që më dërguat nuk ishte vetëm për mua një surprizë e këndëshme ndonse ishte botuar vetëm në gjuhën shqipe...Po pati mundësi të shpenzonit edhe një kopje tjetër për bibliotekën time personale,dhe në se do të ishte e mundur të ma dërgonit edhe me dedikim tuaj personal do të ju isha shumë i obliguar".*

* * *

49 FERME PARK ROAD
STROUD GREEN
LONDON N4 4EB

(01) 340 5987

Date

11 November 1987

Mr Abaz Hoxha,
Albanian State Film Archive,
rue Alexandre Moisiu nr.76,
Tirana, Albania.

Dear Mr Hoxha,

I regret that I have had no great success with the two questions you asked me in your letter of 17 March -- and it has taken me some time to receive the results.

On the book about the Manaki brothers, my correspondent in Belgrade replies:-
"The book "Brati Manaki" by Pavle Konstantinov is out of print, and our librarian assures me there is no chance of obtaining a copy. The publisher was not satisfied with the book, and withdrew all the remaining copies from circulation."
I'm afraid that sounds rather final!

Geoffrey Donaldson tells me that he has sent you some material on Charles Urban's activities, and recommends you to write to the Science Museum (Exhibition Road, London SW7) who have a large collection of his documents. If you write to them, they may be able to photocopy items relating to Albania.

You didn't tell me whether you had ever heard from David Francis at the British Film Institute after my enquiries in 1983 about documentary film of Albania before World War Two. Anyhow, I rang their film archive section again last week to see if they had anything. Not much, it seems. But there is a 1929 travelogue called "Corners of Europe", which has a section on Albania showing scenes in Tirana and Shkodër, as well as mountain villages with national dances and costumes.

If you think this would be worth copying, write to the National Film Archive at its new address: 21 Stephen Street, London W.1. I also enquired at a documentary film agency, but they had nothing except modern stuff on Albania.

I send you all good wishes for progress on your research into the history of the Albanian cinema. It will be a most valuable work, and I hope it can be translated into English or some other widely distributed language. You are privileged to live in a small, beautiful, unspoilt country, but you have problems in being read elsewhere!

Geoffrey N. Donaldson

3011 ST ROTTERDAM
Groenendaal 209
Telefoon (010) 41 33 118

HOLLAND

22nd October 1987

REGISTERED

Mr Abaz Hoxha,
Arkivi Shtetëror i Filmit i R.P.S. Të Shqipërisë,
Rruga Aleksander Moisi 76,
TIRANA,
A L B A N I A.

Dear Mr Hoxha,

I have read your letter of 7th October 1987 with great interest ... but I am sorry to have to confess that I know nothing at all about the history of cinema in Albania!

I presume that our mutual friend in London must be John Holmstrom, who wrote to me very enthusiastically about his visit to Albania and to the Albanian Film Archive a few years ago. [John brought back from Albania some seeds of what he calls "the ejaculating cucumber". I too have been trying to grow these plants on my balcony, but with not much success. This year six plants had flowers, but no cucumbers developed. I am afraid that the Dutch climate does not suit this particular kind of cucumber from Albania.]

But now let us talk about films.

I do not know of the existence anywhere of any films made in Albania in the early years of this century. If I were looking for such films, I would start by making enquiries at the National Film Archive in London, the Jugoslovenska Kinoteka in Belgrade, the Tainiothiki tis Ellados in Athens and some of the Italian film archives. I suppose, however, that you have already contacted these archives.

I have never corresponded with the Greek Film Archive and have no contact at all with film historians in Greece.

With respect to Yugoslavia, I should like to suggest that you write to:

Mr Dejan Kosanović,
11000 BEOGRAD,
Ivana Milutinovića 78,
JUGOSLAVIJA.

Mr Kosanović is an authority on the early years of cinema in his country - and he may be able to help you with information concerning films made in Albania. In 1985 he published a book called "Počeci kinematografije na tlu Jugoslavije 1896-1918" (The Beginnings of Cinematography on Yugoslav Soil), which contains information about films made in the Balkan countries by various foreign companies (Pathé, Gaumont, Messter, Charles Urban). There are also notes about the English cameraman Noble Charles Rider who

/ 2

Mr Abaz Hoxha - 3 - 22nd October 1987

color films in the Scala Theatre, London, either in 1911 or in 1912. One of the films shown was called THE WAR IN THE BALKANS. Even the name of the director (probably also cameraman) is mentioned: Frederick Villiers.

- the synopsis of a Kinemacolor film called A BALKAN EPISODE. This was, of course, a fiction film in which the Balkan War was used as the background for a romantic story. The actual country in which this story is supposed to take place is not mentioned. Of course this film was made in Urban's Kinemacolor studio in Hove (England) or in Nice (France) - and it was probably directed by Theo Frenkel Bouwmeester. This item is only of "curiosity value".

- an advertisement from a Dutch newspaper of 30th October 1912 announcing the screening of a news film called OORLOG IN DEN BALKAN (= War in the Balkans). As this film was shown in Theater Pathé (in Amsterdam), it is safe to assume that it was made by a Pathé cameraman "somewhere in the Balkans".

And that, Mr Hoxha, is all I have in my files about films made in the Balkan countries.

I hope that this letter and the enclosures will be of some assistance and interest to you. If I come across any other material on this subject I shall let you know in due course.

.....

It seems to rather unlikely that any Dutch silent films ever reached Albania, but it is possible that some of Pathé's so-called "Hollandsche Films" were shown there. I should greatly appreciate your letting me know if ever you come across material concerning the screening of Dutch films - silent or sound - in Albania.

All best wishes!

Yours sincerely,

Geoff Donaldson

Rieti, feb. 19, 1988

ea:

Dear Sir,

In answer to your kind letter of january 18, I can tell You the following informations I took from the italian lists of censure:

1914: Durazzo - visa 2757 of 27.3.1914 - prod. Savoia-Film, Turin

1915: Fuoco e fiamme nei Dardanelli e sui mari - visa 10077 of 1°. 8.1915 - prod. Lombardo, Naples -

Salonicco - visa 10772 of 1.12.1915 - prod. Savoia, Turin

1916: Montenegro - visa 11048 of 1°.2.1916 - prod.Savoia - lenght 124 m

La prodigiosa opera della Marina italiana in aiuto dell'esercito serbo - visa 11488 of 6.6.1916 - prod. Comerio, Milan - camera-man: Luca Comerio -

Campo serbo - celebrazione di una grande festa - visa 11774 of 1° aug.1916 - lenght: 180 mt. prod. Carotenuto, Rome

Vita al campo serbo - visa 11773 of 1.8.1916 - lenght: 196 - prod. Carotenuto, Rome

Flotte ed eserciti alleati a Salonicco - visa: 12103 (nov.1916) prod. Cines, Rome - lenght: 847 mt.

Fronte balcanico - visa: 12134 (nov.1916) - prod. Salvo lenght: 1130 -(the film is also known as Imponente preparazione offensiva degli Alleati).

Dalmazia - visa 12178 (dic.1916) - prod. Ambrosio, Turin - 106 m

1917: Dall'Adriatico all'Egeo (Sbarco delle forze italiane in Albania) visa 12301 (jan.1917) lenght.1090 mt. prod. Marina Militare It.

Dalla ritirata d'Albania alle trincee di Macedonia - visa 12824 (july 1917) - lenght: 1496 mt. - prod: Marina Militare Italiana

Some scenes of dead soldiers lying without sepulture, considered horrorific and bloodcurling, were censored.

I colossi del mare ed i territoriali in Albania - visa 12658 (ma 1917) lenght: 751 mt. - prod. Marina Militare italiana.

1918: Albania liberata - visa 13773(aug.1918) - prod. U.S.F.G.F (I don t know if it is an italian or foreign documentary)

Bombardamento di Durazzo - visa 13858(dec.18) l. 192 mt. prod; Marina militare italiana -

I will search after 1918, at the moment I don't have the next censure lists. In the years 1914/18 there are many documentary relating Balcans, made by Gaumont, Pathé, Eclair, the british section of newsreels.
There are also two fiction films, the first made in 1927 in Italy named Nanù, la cugina d'Albania, a comedy, and the other Il cavaliere di Kruja, made in 1940 in Albania, shortly after the italian occupation of Albania.
Enclosed here, please find two photocopies of scores of the two pictures, where You can have a synopsis and contemporary critics of the films.
I give You also the adress of another italian, who is now writing about war documentaries and cinematographers, who have taken films during first and second world war. He may can help You:
Franco Cocchi - Via Valmalenco 40 - 23100 Sondrio -

Please, accept my best wishes for your work

P.S. Can You tell me if in the albanian archives are italian silents (fiction)?

Abaz Hoxha

Mr. Dr. VITTORIO MARTINELLI
02100 Rieti, Via Leonessa 24

Tirana 24.5.1988

Dear Sir,


Thanks you very much for your informations about the shooting of newsreels documentaries and fiction films in Albania by Italian cinematographers.

On that ocassion I have the pleasure to send you a copy of my book " FILMI ARTISTIK SHQIPTAR ". This is a complete filmography of Albanian feature films produced by Albania film studio " Shqiperia e re "(New Albania) and Albanian Television from 1957-1984 with a short historical aproach. Unfortunately by now we haven't it in other widely distributed language but I hope that it will be soon in English version.

About your request I inform you that in our Archive they are not Italian silent films.

Best regards.

Yours Sincerely
Abaz Hoxha



DEUTSCHES INSTITUT FÜR FILMKUNDE (DIF)

Sitz Frankfurt am Main

Mitglied der Féderation Internationale des Archives du Film (FIAF)

Deutsches Institut für Filmkunde e. V. · Schaumainkai 41 · 6000 Frankfurt 70

☐ Abt. Dokumentation/Informatio
Schaumainkai 41, 6000 Frankfurt 70
Telefon 069/617045

Mr. Abaz Hoxha
Directeur
ARCHIVE D'ETAT DU FILM
DE LA R.P.S. D'ALBANIE
Rruga Aleksander Moisiu 76
Tirana / ALBANIA

11. 4. 1988
10crD

Dear Mr. Hoxha,

It was a pleasure to read your letter dated March 24, 1988 which came in today. But the marvellous book on the Albanian film production which was sent with, was not only for me a useful surprise, even if it's printed in the Albanian language. But as all filmographic data are clearly given above each entry it enables us to follow names and functions of the participants in the production. For to avoid any false relationship to the function given in abbreviations, we should like to ask you to explain and to translate into English these initials.

If you could spare another copy for my private library and if you, moreover, could be kind enough to write a personal dedication in it, I should be much obliged to you.

Please don't hesitate and let us know if there is anything we can do for you with regard to any information on the German pre war and Federal German cinema.

Best wishes and kindest regards, also to your colleague,

very sincerely yours


(Eberhard Spiess)
Deputy Director

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Hoxha, Abaz
Në gjurmë të filmave për Shqipërinë / Abaz Hoxha. - Tiranë : 2007.
128 f; 20.5 cm

ISBN 978-99927-742-8-1

321.74 (496.5) "1945/1990"



ISBN 978-99956-611-6-8

Në Gjurmë të Filmave për Shqipërinë

Kujtime-Mbresa-Shënime udhëtimi

Çmimi 400 lekë